



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 115, Maj 2013

Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

"Papa Klementi XI dhe familja Albani", konferencë shkencore në Universitetin "Luigj Gurakuqi"

9

Qendra e Studimeve Albanologjike organizoi, me 22 maj 2013, në sallën e konferencave të Universitetit "Luigj Gurakuqi" të qytetit të Shkodrës, konferencën shkencore me temë "Papa Klementi XI dhe familja Albani". Kjo konferencë u zhvillua përpara një auditori të zgjedhur me profesorë të gradave të ndryshme shkencore, pedagogë, intelektualë, përfaqësues klerik, të qeverisjes vendore, Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, Gjergj Leqejza; Prof. Dr. Eqrem Elezaj, autori i një monografie mbi këtë argument; Prof. Richard Potz, nga Universiteti i Vjenës; Rektori i Universitetit të Shkodrës, Prof. Dr. Artan Haxhi, si dhe Prof. Dr. Ardian Marashi, drejtor i Qendra e Studimeve Albanologjike. Konferencës në fjalë i parapriu një ekspozitë me riprodhime gravurash të epokës, e hapur në mjediset e universitetit të Shkodrës, në të cilën pasqyroheshin disa prej etapave më kryesore të historisë të shumë viteve më parë, dhe më konkretisht të familjes Albani, që i përket edhe Papa Klementi XI.



KRYENGRITJA OPOZITARE E SHKODRES - 31 MAJ 1924

6

- LUANIN E TOSKNISË (FERIT FRASHRIN) E VRAU LUANI I SHALËS (GJELOSH MARKU) - DUKAGJINI MORI PROFEKTUREN

Në pranverë 1924 situata e brendshme politike mes forcave qeveritare dhe të Opozitës demokratike Fanoliste, acerohet akoma më shumë. Nga ana e opozitës pas vrasjes së Avni Rustemit me 5 maj 1924, filloi një punë e gjerë dhe e organizuar për të përgatitur kryengritjen dhe për të bërë për vete ushtrinë. Përgatitjet bëheshin paralel si në Shkodër ashtu edhe në Vlorë.

ME ATA QË E BËJNË GURIN TË QESH



4

NGA SHESHI... PO VIJ!

Kjo ishte përgjigjja që morëm unë dhe një miku im, me të cilin po ecnim qetë-qetë nëpër rrugët e shkallmuara të këtij qyteti sa mjeran aq edhe me vetëdije të humbur, nga një burrë rreth të pesëdhjetave në mesin e të cilit lexohej trishtimi dhe vetem trishtimi.

2

Dod Tahiri, kreshniku i portës Shqiptare

8

"Qytetarë nderi" i Komunës së Shoshtit dhe "Nderi" i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", biznesmeni shqiptaro-amerikan Ndue Ftoni

2

SIGMA



VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:
NDUE FTONI



NGA SHESHI... PO VIJ!

editorial nga LAZER KODRA

Kjo ishte përgjigja që morëm unë dhe një miku im, me të cilin po ecnim qetë-qetë nëpër rrugët e shkallmuara të këtij qyteti sa mjeran aq edhe me vetëdije të humbur, nga një burrë rreth të pesëdhjetave në fytyrën e të cilit lexohej trishtimi ...dhe vetem trishtimi. Zhurma degjohej gjithandej. Një foni, si re smogu kishte mbuluar qytetin tim...dhe tëndin i dashur lexues. Kishin mbrritur ata...ata që në skenën shqiptare të shekullit të njëzet e njëtetë po insatolonin tentakulat, amalgamë të Partisë së Punës, për t'ia servirur këtij qyteti me një kulturë, të dikurshme të admirueshme, saqë vetë Montanelli e përmbillte me shprehjen: "Shkodra më ngjan me një Firence të vogël." Dhe duam...s' duam ne, pasi disa nuk e duan fare, Firencia ishte vendi ku Rilindi Evropë, vendi ku u 'gdhenden' kohrat e së ardhmes evropiane, vendi ku 'mbiu' Da Vinçi, Mikelanxheloja Petrarca, Bokaçio dhe i Madhi Dante Aligeri. Sa mund është për qytetin tim që të pranohet një gjë e tillë!? E gjitha kjo ndodh ngaqë termi Rilindje u kallë një lloj 'krrupe', të pashjegueshme. Atë mësuar me thënien: "Jam me atë që sundon kalanë", të vetëlavdruar në çdo moment me shprehjen: "Jemi djepi i kulturës!" kanë pranuar apriori 'petkun e monotonisë, kënaqësinë naive të fryrjes së barkut dhe kanë hedhur mënjëanë çdo për-

masë të dimensionit njerëzor. Por le t'i kthehem problemit. Gjëmimi vinte nga sheshi. Organizatat e "masave" kishin marrë e zbatuar të gjitha udhëzimet e "Lartëmadhërisë" që njerzit

për krijesën e ndyrë që gatuan petanikë e dredhanikë nga furra e Partisë së Punës! Nëse dikush ka vdekur, larg qoftë, dhe është nevoja për përdorimin e celularit...edhe kjo nuk përbën ndonjë problem, pasi thënia Makiaveliane: "Qellimi justifikon mjetin" shtrihet nga rrogatë 'prapanicë' lëpëres, në të gjitha qoshet e

nga sheshi tek thoshte: "Jemi të dytët në Evropë!", "Do të bëjmë vizat me SHBA-në!", "Punësim për të gjithë!", "Mirëqënie për të gjithë!", "Drejtësi për të gjithë!", "Do të bëjmë gjithçka për atë e për këtë-që do të thotë shtetërore e ideve!"... dhe çjerret mytevi, mbushnin hapësirat qiellore ku Fishta, Mjeda, Gur-

ar nga klikat zhurmëmëdha e punëpake që po e mbytin këtë vend me emrin Shqipëri. Duke e njohur se i përkiste shtresës së persekutuar, jo për vjedhje apo vrasje, por për mendim e ide ndryshe nga ç'kishte Partia e Punës, unë e pyeta: "Po pse nuk jeni tek sheshi?"-Nga sheshi po vij, m'u përgjigj! Po sheshi po gjemon përsëri, i thashë unë!-Unë po vij nga sheshi "Isa Boletini", u përgjigj ai, -prita qysh në nadje për punë e nuk gjeta, tani po kthehem në shtëpi, ndersa ai sheshi, për të cilin po flet ti, ka vdekur edhe për mua! "U largua i heshtur, me supë të varura nga pesha e varfërisë, me shpresa të humbura, bjerradiës në kërkim të mbijetesës. Në kokë i ishin përzier dy kohra të zeza: Ajo që e kishte pësektuar, koha e P.Punës dhe ajo që po e mjeronte: E tashmja absurd! M'u duk sikur e këputa një copë nga dhimbja e tij dhe u ktheva në shtëpi. Midis librave të bibliotekës sime nxorra një liber të të madhit Martin Camaj të titulluar "Gedichte", nga ku shkëputa katër vargje të poezisë me titull "Elegji e parë": "Por unë do të vdes mes njerzve gjithmonë/ të ngjishëm/ prandej ndër drekët e mija qitni/ vetëm kafe të idhta!" Lexova keto vargje nga kjo liber për një arsye fare të thjeshtë: Burri që kisha takuar ishte pikërisht nipi i Martin Camaj! Sa të vegjël m'u duken llafazanët e sheshit dhe sa e madhe ishte ëndrra e njerzve të këtij vendi!



të ishin aty! Aty tek sheshi, ku arkaizmi patologjik për kultin do të rishfaqej e rishfaqej radhazi për të disaten herë nën moton: "Besoni çfarë flasim e mos shikoni çfarë bëjmë!" Cellularët mbetën pa sinjal për dy orë. "Perendia e qytetarëve të mi ka zbritur në tokë!" Ç' turp! Ç' mungesë vetëdije! Ç' fyerje për të gjithë ne!? Nëse një i sëmurë nuk arrin të komunikojë me të afermit...kjo s'përbën kurrëgjë

ketij qyteti si justifikim vulgarë. Nëse një shtëpi mirrte zjarr dhe zjarrfikësja nuk mund të njoftohet... atëherë padronet e qytetit tonë do të thurnin lloj-lloj sajesash monstruoze, siç ndodhë rëndom me përmbytjet, vonesat e pagave, korrupsionin, të ndjerën drejtësi, arsimin me 57% analfabet funksional, shëndetësinë ku njeriu 'humbet' shendetin e qindra të tjera probleme. Zëri i çjerrur, i dikujt, u dëgjua

akuqi, Migjeni, Shiroka e shumë të tjerë i kishin dhënë emrin e dikurshem qytetit tonë aq të mirë e aq të perdhosur që nga mesi i shekullit të kaluar. Pikërisht në këtë situatë trishtuese, aty tek Kisha e Shënkollit, takojmë atë burrë rreth të pesëdhjetave që ecte i menduar, pak i krrusur, në sy i lexohej zhgenjimi, me fjalë shprehte varfërinë, dhe në gjithë qëndrimin e tij jepte portretin e njeriut të robëru-

"Qytetarë nderi" i Komunës së Shoshit dhe "Nderi" i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", biznesmeni shqiptaro-amerikan Ndue Ftoni

"Qytetarë nderi" i Komunës së Shoshit për biznesmenin shqiptaro-amerikan, Ndue Ftoni

Në qytetin e Shkoder Loces, janë mbledhë qindra shoshjanë, banorë sot të këtij qyteti, por edhe të "ulun" për të marrë pjesë në ceremoninë e dorzimit të titullit "Qytetar nderi" i Komunës së Shoshit, nga ka origjinën dhe Ndue Ftoni, sot banor i përherëshem në SHBA-ës. Me propozimin e një grupi keshilltarësh të Komunës së Shoshit, keshilli i saj i ka dhënë titullin e lartë, që mund të japi ai institucion, bazuar në ligjet e shtetit Shqiptarë "Qytetar nderi".



Momente te dorzimit të titullit nga kryetari i komunes, Mark Kulla

ta "Atdhetare-Dukagjini" me qender në Shkoder, ansambli "Treva", humoristi Gezim Kruja dhe aktorja e Teatrit dhe Estrades Profesioniste Shkodrës Raimonda Marku. Gjithashtu ishin te pranishem edhe një grup nga Nënprefektura e Malësisë së Madhe, me në krye N/prefektin e saj, Sytki Ndreca.

Në këtë veprimtari, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" me Qëndër në Shkoder i dorzoi titullin e lartë "NDERI" i shoqatës, Ndue Ftonit.

Ketë titull ja dorzoi Anetari i Nderit të Shoqatës, Mjeshtri i Madh, Fadil Kraja.

Nga Rush Dragu



Ndue Ftoni duke marrë titullin, nga Mjeshtri i madh Fadil Kraja

Manifestimi Tradicional "Zëri i Vëllazërisë 2013"

Në kujtim të përvjetorit të Kryengritjes në Malësinë e Madhe edhe këtë vit Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" ka organizuar Manifestimin Tradicional "Zëri i Vëllazërisë". Është ky Manifestim që vazhdojë të bëjë bashkë në një këngë, valle, në lartësim kujtimi për dëshmorët e në një

Shoqatën "Martin Dreshaj" për angazhimet në mbajtjen gjallë të Zërit të vëllazërisë. Në këtë atmosferë e pas prezantimit të mrekullueshëm të tij, këngëtarit e intelektualit nga Istogu, Ismet Demajt, ka pranuar urimet për titullin magjistër. Ukshin Jashari në cilësinë e kryetarit të Shoqatës "Martin Dreshaj" ka falënderuar kry-

bërë një në vallen e bukur shqiptare. Këtu në Klinë e në takimet letrare është bërë një befasi e bukur që ishte përgatitur nga Aleks Dushi e aktorët nga Shkodra e në bashkëpunim nga Prend Buzhala, Indriz Berisha, Ismet Kasniqi-Lala dhe Drejtoria e Kulturës në Klinë. Në sallën e bukur të Asamblesë janë prezantuar mrekullueshëm jeta dhe



trevese Ansamble, këngëtarë, poetë e intelektual të sferave të ndryshme nga Shkodra, Malësia, Kosova Lindore dhe trojet tjera etnike.

Manifestimi ka nisur me Tryezën tematike "Bashkë mund të bëjmë më shumë" në të cilën janë prezantuar me temat e tyre intelektualët nga Shkodra, Lazër Kodra e Luigj Shyti, Naim Martini nga Gucia, Anton Lulgjuraj nga Malësia e Madhe dhe Frashër Rraci nga Kosova. Temat kanë qenë përmbajtësore dhe një ekip intelektualësh nga Shoqata do të nxjerrë nga to një program të angazhimit të përbashkët mes Shoqatave nga trojet etnike pjesëmarrëse në këtë Manifestim. Pas kësaj pjesëmarrësit e Manifestimit janë gjetur mes qytetarëve të Pejës duke vallëzuar e kënduar bashkërisht. Ashtu të bashkuar ata kanë vënë kurora lulësh te busti i Shkëlzen Haradinajt dhe dëshmorëve të tjerë. Ishte kjo dita e parë festës e cila ka vazhduar e bukur në qytet të Istogut. Atje pjesëmarrësit janë përshëndetur nga përfaqësuesit e institucioneve komunale e nga qytetarët e shumtë dhe bashkërisht kanë lartësuar kujtimin për dëshmorët dhe kanë hedhur valle të trojeve etnike. Në Istog pas kësaj ka jehuar kënga e Ansambilit "Selman Kadria" e pastaj pjesëmarrësit nga trojet etnike dhe publiku janë gjetur në vallet e prezantuara nga Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" me koreografin Aldo Nika dhe ata të Ansambilit "Majat e Karafilave" nga Plava e Gucia të udhëhequr nga Gani Kukaj. Bukur janë prezantuar edhe Grupi Folklorik "Shpëtimi" nga Medvegja e Kosovës Lindore. Drejtori i Arsimit në Istog, Agim Haxhiu, ka përshëndetur pjesëmarrësit, u ka dëshiruar mirëseardhje dhe ka lavdëruar

etarin e Istogut, Haki Rugova, institucionet komunale dhe veprimtarët e kësaj komune për përkrahjen dhënë Manifestimit e pastaj ka shpallur për anëtarë nderi të Shoqatës Ndue Sanajn, Roza Pjetrin, Aleks Dushin e Gani Kukajn, Jashari ka falënderuar publikisht edhe veprimtarin Faton Bytyqi për angazhimet e tij të vazhdueshme në përkrahje të Manifestimit dhe ka ndarë çmimin "Sali Mani" për Bacën Kapllan Nikqi, i cili një jetë është në shërbim të valles së bukur rugovase. Në atmosferë feste Shoqata ka nderuar me çmimin "Martin Dreshaj" poetin e kritikun Prend Buzhala, Valdet Hysenaj, Teatrin "Aleksandër Mosiu", flamurtarin e Shoqatës, Bacën Shefki Halimi dhe publicistin e poetin Sejdi Berisha.

Atmosferën e festës e ka shtuar kryetari i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj, i cili pasi ka lavdëruar angazhimet dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me Shoqatën "Martin Dreshaj" ka shpallur vendimin e Kryesise se kësaj Shoqate, që në kuadër të krenimit dinjitoz të dhjetë vjetorit të punës së saj dhe pese vjetorit të bashkëpunimit midis dy shoqatave tona, të nderoi me titullin "Anëtar nderi" luftëtarin e lirisë, kolonelin Avdyll Mushkolaj, veprimtarin Naim Martini, Frashër Rracin, Drita Kasniqin, Qëndresa Jasharin, Ismet Demajn, Ansamblin Selman Kadria, Drejtorinë e Kulturës në Klinë dhe Prend Buzhalajn.

Në ditën e dytë, veprimtaria ka vijuar në Klinë. Pjesëmarrësit janë përshëndetur nga qytetarët dhe institucionet komunale dhe bashkërisht kanë vënë kurora lulësh te përmendorja e dëshmorit Mujë Kasniqi dhe te ajo e Nënës së Madhe shqiptare, Nënë Terezë. Nga aty ata janë drejtuar te ndërtesa e Kuvendit Komunal dhe janë

vepra e penave të mëdha shqiptare Martin Camaj, At Vinçenc Malaj, Azem Shkreli dhe Ali Podrimja.

Organizatori këtu ka falënderuar njeriun e parë të Klinës, Sokol Bashota dhe institucionet komunale për mikpritjen, kurse nënkryetari i këtij qyteti, Zenun Zeqa, ka përgëzuar gjithë të angazhuarit në këtë Manifestim duke shtuar se këto janë momente kur shqiptarët janë bashkë në një valle, këngë e në një tevesë dhe kujtojnë bashkë emra të mëdhenj të nacionalitetit tone.

Në Glogjanin e historisë e në Deçan

Në përmbyllje të Manifestimit, pjesëmarrësit e kësaj feste janë gjetur në Glogjanin e historisë. Aty ata janë prituri nga Baca Ilmi Haradinaj dhe bashkërisht në Kompleksin e Dëshmorëve të Nacionalitetit tone, kanë lartësuar kujtimin për ta që kanë rënë për të mos vdekur kurrë. Pas kësaj në konakun e Haradinajve është zhvilluar një bisedë e ngrohtë e vëllazërore.

"Jemi të nderuar me vizitën tuaj vëllezërore e motra nga trojet etnike. Ju që po nderoni kujtimin për dëshmorët po nderoni shqiptarinë", ka thënë Baca Ilmi. Kryetari i shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj, në emër të kryesise së Shoqatës, Bacës Ilmi, ju dorëzua Medaljoni i Shoqatës sonë për djalin e Tij, Ramush Haradinaj, me motivacion: "Për kontributin e jashtëzakonshëm të dhënë në Luftën pa kompromise për Çlirimin e Kosovës. Një personalitet i veçantë i vlerave njerëzore e nacionale. Heroi i Përvjetorit në shërbim të nacionalitetit shqiptar; Lider në luftën për emancipimin e shoqërisë kosovare drejt standardeve euroatlantike".

(VIJON NË FAQEN 9)

MARIJE TEMALI, HEROIN E PUNËS

Marije (Gjoni) Temali, lindi në Shkodër, me 4 prill 1942. Pas vdekjes së babës së saj, Zefit, nëna u përballë me vështirësi të mëdha ekonomike. Ajo kishte për të rritur e shkolluar katër fëmijë jetim.



Në kushtet e krijuara pas çlirimit, me hapjen e ndërmarrjeve ekonomike, arsimin e shëndetësinë falas, u bë e mundur që fëmijët të rriten, të përfundojnë shkollën 7 vjeçare, të punësohen në profesione të ndryshme dhe graduallisht po kalonin vështirësit e rritjes së tyre.

Marija, pasi përfundoi shkollën e mesme, u punësua në fabrikën e Tisazhit, si tezgjahiste për krah shume grave e vajzave shkodrane. Ajo dallohej në mes shoqeve të saj për disipline në punë, aftësi profesionale e ndërgjegje të lartë. Kur e lypte nevoja, ajo punonte jo vetëm me një tezgjah, por edhe me 2-4 tezgjahë, për t'u realizuar detyrat e planifikuar në brigade apo në repartin ku punonte e drejtonte.

Marija për krah heroinave të tjera, Hatixhe Kraja e Sadie Rexhepi, me dinamizmin e përkushtimit e saj përhapte përvjetjen e përpunuar në repartet e fabrikat e tjera të ndërmarrjes.

Nuk u mjaftua me arsimin e mesëm, por me shkëputje nga puna, vijojte shkollën e lartë të Partisë, për të përballuar më mirë detyrat në rritje si kuadër e aktiviste shoqërore.

Në tetor të vitit 1974, Presidiumi i Kuvendit Popullor i akordoi titullin e lartë "Heroine e Punës Socialiste".

Në vitin 1978-1982 është zgjedhur deputete e Kuvendit Popullor të Shqipërisë. Ka mbajtur funksione të larta si: Anëtare e Presidiumit të Kuvendit Popullor, Sekretare e Komitetit të Partisë së rrethit Shkodër, Kryetare e Frontit Demokratik të rrethit Shkodër, e të tjera.

Marijen gjithnjë e ka karakterizuar thjeshtësia, kuraja për të ngritur e zgjidhur problemet që dilnin në qendra pune e kooperativa bujqësore, veçanërisht për punësim, shkollim e pjesëmarrje të grave në jetën politike e shoqërore, duke e konsideruar baze për emancipimin dhe ngritjen e tyre në përgjegjësi.

Marija e martuar me Luigj Temalin, ishte një bashkëshorte e përkushtuar për mbare-vajtjen e përballimin e detyrave në familje, ndonëse ishte e ngarkuar me shume detyra shtetërore e shoqërore.

Edhe pas vitit 1993, kur Marija doli në pension, u detyrua të punojte duke u marr me tregti të vogël ambulante, për të përballuar mirëritjen e dy vajzave në kushtet e ekonomisë së tregut duke u krijuar kushtet të mbarojnë shkollën e mesme e të lartën me rezultate shume të mira. Ajo, megjithëse vijonte të punonte, asnjëherë nuk u shkëput nga aktivitetet që organizonte Komiteti i Veteranëve të Luftës Nacional-Çlirimtare, si dhe të veprimtarive të Partisë Socialiste në Shkodër.

Sëmundja e rende që u zbulua para tre vjetëve, nuk e mposhti vullnetin e deshifruar për të vijuar punën e aktivitetin shoqërore. Ishte Heroine e vërtetë!

E humbi besimin se nuk mund të përballohej kjo sëmundje e rende në 2-3 muaj para vdekjes. Kështu u nda nga jeta me 12 prill 2013.

Me vdekjen e Marije Temalit, familja humbi njeriun më të dashur, Komiteti i Veteranëve, pasardhësen e idealeve të Luftës Nacional-Çlirimtare, dhe të punës së madhe që u bë nga populli i rrethit Shkodër dhe gjithë Shqipërisë gjate gjithë periudhës mbas çlirimit dhe Shqipëria femrën aktive për emancipimin e grave e vajzave.

Me dhimbje e respekt, Marija u përcoll për në banesën e fundit, nga familjaret, veteranet dhe e gjithë shoqëria.

Nga Suzana Çepi, pensioniste

ME ATA QË E BËJNË GURIN TË QESH

-Reportazh-

Në një ditë të kësaj pranvere, së bashku me Zef Vuksanin, shkojmë në Grudë të Re në shtëpinë e Fran Shytanit. Ai së bashku me gruan e tij, Filen, djemtë e tyre Sokoli e Sandri dhe me nuset e tyre, na presim me shumë qejf. I pranishëm është edhe djali i djalit, Davidi, i cili nuk i ndahet gjyshit të vet, por ishte edhe shumë i dëgjueshëm edhe pse tre-katër vjeç. Ai i hidhej në qafë gjithë dashuri, e përqa-fonte pa pushim. Jemi shumë shokë ne të dy – thotë Frani. Shtëpia e tyre është e re dhe ndërtuar me shumë kujdes. Të bie ne sy oxhaku i punuar shumë bukur. Të gjitha punimet dhe zbukurimet janë prej guri. Duket sikur “kanë bërë” një marrëveshje me gurin kjo familje sepse ai “u bindet” pa mëdyshje atyre.

TRADITA VAZHDON ...

Ndërsa bisedonim shumë përzemërsisht, Frani dhe Zefi, fillojnë e kujtojnë mjeshtërit e gurit në Dukagjin. Flisnin për ata që ndërtuan shtëpi në të gjithë anët e tij, shtëpi që i rezistuan kohës shumë gjatë.

Është mirë ti kujtojmë, të paktën ata që mund të na vinë në mendje sepse kanë derdhur mundin, djersën dhe dijen për ndërtimin e shtëpive –thotë Zefi, dhe duke ndihmuar njeri tjetrin kujtojnë: Can Bashota Pecaj, Lulash Bala Nënnavriq, Ndue Kola Abat, Pjetër Zefi Gimaj, Lush Toma Plan, Prelë Kola Plan, Ndosha Kola Plan, Kolë Nika Plan, Jakë Zefi Mgullë, Zef Mirashi Gimaj, Dedë Ndoja Theth, Prelë Kola Theth, Dodë Lishi Theth, Vatë Nika Theth, Palush Kola Lotaj, Martin Zefi Celaj, Kuc Delia Palaj, Zef Mirash Ndoj Gjocaj, Lekë Curi Theth, Llesh Prelë Alia Theth, Palok Vata Theth, Sokol Zogu Theth, Mark Marashi Theth, Hil Ndou e Gjergj Hila Abat, Prekë Ndou Gimaj, Ndokë Nika Vuksanaj, Shpend Vocri Vuksanaj, Gjelo Zogji Theth, Pjetër Deda Pog, Tomë Lulashi Khan, Zef Marku Khan, Shuk Kola Theth, Martin Kola Abat, Nikë Marku Pecaj, Ndue Gjon Ndoka Khan, Lulash Gjon Kola Kir, Ndue Gjon Thana Kir, Nikë Pepa Pepaj, ndërsa për fshatin Toplanë duhet me thënë se janë pothuaj të gjithë mjeshtër shumë të mira për ndërtimin e shtëpive, por Zef Rustemi dhe Ndoj Prëndi kanë qenë më të përmendur ndër ta, e të tjerë. Janë shumë dhe nuk na kujtohen të gjithë në këtë moment- thotë Frani, por duhet tua dimë por nder për punën e tyre me gurin, në radhë të parë sepse ka edhe shumë të tjerë që kanë qenë mjeshtër druri shumë të mirë. Shumë nga këta që përmendëm kanë punuar edhe me dru.

Dedë Marashi dhe Can Bashota ishin kryemjeshtër në ndërtimin e spitalit në Breglumi në fillim të viteve '50, që është një mur shumë interesant për mënyrën e ndërtimit.

Biseda kthehet përsëri te familja e Franit dhe përqendrohemi se, si po transmetohet mjeshtria e punës me gurin nga brezi në brez. Po të tregoi unë, ndërhyjnë Zefi, tek e pa se Frani përtonte të fliste për veten. Këta janë 4 breza që punojnë me gurin. Ka qenë gjyshi i Franit,

Marashi, pastaj babai i tij Deda, është vetë dhe mjeshtër e kanë marrë edhe djemtë e tij, Sokoli dhe Sandri. Edhe Davidin mos ma harro, thotë Frani, se edhe ky me siguri do të bëhet mjeshtër, por do të na e kalojnë ne, sepse do të bëhet mjeshtër me shkollë. Ne nuk kemi pasur shkollë, - thotë Frani, por kemi punuar dhe mësuar njëherësh, duke pa e duke ba. Por, dëshirë kemi pasur dhe ju kemi përkushtuar punës.

e di mirë a ishte instruktor i Komitetit të Partisë apo sekretar. Pas disa përshëndetjeve të thjeshta, ata i ripropozojnë dhe japin sqarime plotësuese në prezencën time, duke vlerësuar punën që kisha bërë dhe që ata i kishin parë. Nga është pyeti ai shumë fytyrëngrysur. Nga Lotaj i Shalës i thotë drejtoresha. Në këtë moment Fejzia mori një qëndrim edhe më rreptë, qëndroj pak sikur po kujtonte diçka që mund të kishte lexuar më parë (mbase



“PSE, KA MBET SHKODRA PËR TA NDËRTUAR SHALJANËT...?!”

Fran Shytani është nga fshati Lotaj i Shalës. Një familje tradicionalisht e mirë por, kishte një “dregëz” në biografi. Kjo dregëz, kjo njollë, si edhe të gjithë ata që i kishin, do ti shoqëronin gjatë gjithë jetës së tyre. Edhe për punë krahu u lexohej, edhe për mjeshtri guri apo druri do tu lexohej, deri edhe me punua në kanal në një vepër të kohës u lexohej e sitej.

Punoja në Koman në vitin 1986 - tregon Frani, dhe aty fillova të perfeksionohem në gdhendjen e gurit. E kisha shumë me dëshirë këtë profesion. Në atë kohë Shpresa Prifti ishte Drejtore e Monumenteve të kulturës në Shkodër, Zef Çuni ishte arkitekt dhe Ferid Kola punonte si piktor dhe skulptor në monumentet e kulturës. Ata kishin marrë njohuri për cilësinë e punës time me gurin dhe për këtë arsye kishin propozuar që të kaloja si punëtor i përhershëm në mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës në rrethin e Shkodrës. Drejtorja e Monumenteve të Kulturës së Shkodrës propozon organeve të shtetit të kohës në rreth që unë të kaloja si punëtor atje. Një ditë më thërrasin dhe së bashku me drejtuesit e Monumenteve të kulturës shkojmë në Komitetin e Partisë ku na priti Fejzi Spahia, nuk

biografia jo e mirë për atë kohë, apo prejardhja nga Shala). Pas pak kthehet nga ata e duke kundërshtuar kategorikisht u thotë prerë dhe rreptë: “ pse, ka mbetur Shkodra për ta ndërtuar shaljanët...”. E kuptova se mori fund çdo gjë, por edhe ata që erdhën me mua. I kthyem shpinën ati njeriu që nuk u përpoq fare që të na jepte ndonjë sqarim apo të ndaheshim më butë. Pas asaj pritje tërë hundë e buzë të Fejzi Spahisë unë nuk punova më në kooperativë por fillova punë privat në shtëpitë e malësorëve në shumë fshatra të Shqipërisë së Veriut që nga Gashi e Krasniqja, Shala, Shoshi, Pulti, Bajram Curri, Shllaku e deri në Vermosh.

Më vonë –vazhdon tregimin Frani, më kanë marr për të punuar shpesh herë në mirëmbajtjen apo restaurimin e monumenteve të kulturës, por gjithmonë si provizor. Kam punuar në Shtëpinë e Lulash Keqit dhe Zef Koçekut në Theth, Kolë Vatës në Abat, Breglumi e të tjera.

“KJO TË KA SHPËTUAR”

Me ndryshimet politike në Shqipëri ju drejtova emigracionit, për të rregulluar disi më mirë jetën e familjes time. Punoja 9 vjet atje

Pas një heshtje të vogël Frani, nis të tregojë plot pasion. Kur erdha, vazhdon ai, me pushimet e para nga Italia punuam një shtatore të Zojës së Bekuar dhe vendosa që të marrë me vete për ta vendosur

në një vend të shenjtë aty afër ku rrinim në Itali. Bashkë me mikun tim, Pëllumbin dhe familjen e tij, pasi kaluam doganat po ecnim me makinën e tij në autostradën Bari-Firence. Makina doli nga rruga, nuk e di se për çfarë arsyeje, u ngjitëm në shtat kodrine dhe u rrokullisëm disa herë. Shikuam njëri tjetrin dhe pamë që kishim shpëtuar pa probleme, vetëm me disa gërvishtje. Dolëm si mundëm dhe u çuditëm se si kishim shpëtuar kur makina ishte kthyer në një grumbull hekurishtë. Menjëherë kërkua se ku kishim shtatoren e Zojës. Ne së bashku me makinën ishim rrokullisur mbi 20 m. Shtatorja e

Zojës gjatë rrokullisjeve kishte dalë nga makina bashkë me materialet e tjera që kishim me vete, por mahnitëm dhe u mrekulluam, këtu Frani ndalon, merr frymë thellë dhe duke vendosur dorën mbi kokën e nipit që e kishte gjurin e vet betohet: “pasha kryet e këtij djali e kam gjetur shtatoren e Zojës pa asnjë dëmtim dhe drejt në këmbë”.

U bllokua trafiku dhe me urgjencë erdhi policia rrugore për të na ndihmuar. Kur pa shtatoren e Zojës njeri nga ata, duke bërë me dorë drejt saj, na tha: “Kjo u ka shpëtuar”.

NDREKA ...

Në ballë të oxhakut duket një foto e një burri. Duket fisnik, të duket sikur thotë “unë jam këtu”. Pasi e shikoj disa herë e pyes Franin se e kujt është ajo foto.

Ai bën një “eeeeh” të gjatë, nuk i dalin fjalët nga goja, kapërdihet dhe sytë i ngulë mbi atë fotografi në mur. Skuqet gjithë fytyra e tij, por sytë më shumë. Fërkon kokën dhe bën sikur rregullon kapelën. Me duket se i bën këto lëvizje për të gjetur një farë qetësi, për të mundur që të nxjerr fjalë nga goja. Më në fund flet. Ai është vëllai im, Ndreka – thotë Frani. Për pak ditë mbush 1 vjet që ka ndërruar jetë –vazhdon ai. Franit nuk i rrihet në një vend, por ngrihet dhe lëvizë nëpër dhomën

SEMINAR PER GAZETARET NGA KLUBI SHQIPTAR I MEDIAS

KLUBI SHQIPTAR I MEDIAS KA ORGANIZUAR NË SHKODËR NJË SEMINAR 1-DITOR ME TEMË "RAPORTIMI I GAZETARËVE TË MEDIAVE LOKALE PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE"

Raportimi i gazetarëve të mediave lokale për zgjedhjet parlamentare ishte tema e seminarit 1-ditor të organizuar në Shkodër ditët e fundit nga Klubi Shqiptar i Medias me

gazetarët shkodranë si dhe me mbështetjen e OSBE-së.

Ka përshëndetur të pranishmit Presidenti i Klubit Shqiptar të Medias Shkëlqim Bylykbashi ndërkohë që më pas ka falenderuar për organizimin optimal të këtij aktiviteti edhe koordinatori i kësaj organizate mediatike të shoqërisë civile, Ermir Kasmi. Përshëndeti edhe përfaqësuesi i Klubit Shqiptar të Medias në Shkodër, Ndue Sanaj, njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini".

Më pas i ka ardhur radha për të referuar për këtë temë lektorit Lutfi Dervishi.

"Kodi zgjedhor në Shqipëri meriton që të hyjë në librin "Ginnes" sepse ka 186 nene nga 183 që ka vetë Kushtetuta e vendit. Kjo flet qartë për një klimë mosbesimi dhe një atmosferë jo të qetë Fleta e votimit ka vetëm 3 ose 4 detaje më pak se sa karta e identitetit", u shpreh në fillim të fjalës së tij lektori dhe opinionisti Lutfi Dervishi.

Trainimi ka vijuar edhe në trajtimin e nëntemave të tjera të nevojshme si

-Sigurimi i transparencës maksimale gjatë fushatës zgjedhore mes subjekteve

politike dhe teleshikuesve në respekt të ligjit si dhe hapësirë të barabartë kohe në media gjatë fushatës elektorale.

-Raportimi i ngjarjeve të ndryshme politike gjatë fushatës zgjedhore me kor-

Bylykbashi, "Eksperiencia mbi raportimin e gazetarëve të mediave lokale gjatë proceseve zgjedhore."

Këtu lektorët u ndalën vecanërisht te raportimi i gazetarëve në mënyrë siste-



matike dhe kronologjike të ngjarjeve politike në proces si dhe përdorimi i arkivës për efekt ballafaqimi të programeve të mëparshme elektorale, pra për zgjedhjet në ndihmë të kujdesit të votuesve. Duke u ndalur në këtë pikë, Presidenti i Klubit Shqiptar të Medias Shkëlqim Bylykbashi foli për një anketim që kishte bërë duke

matike dhe kronologjike të ngjarjeve politike në proces si dhe përdorimi i arkivës për efekt ballafaqimi të programeve të mëparshme elektorale, pra për zgjedhjet në ndihmë të kujdesit të votuesve. Duke u ndalur në këtë pikë, Presidenti i Klubit Shqiptar të Medias Shkëlqim Bylykbashi foli për një anketim që kishte bërë duke

Aktiviteti ka vijuar në pjesën e dytë të tij me temën e përbashkët të përgatitur nga Lutfi Dervishi dhe Shkëlqim

matike dhe kronologjike të ngjarjeve politike në proces si dhe përdorimi i arkivës për efekt ballafaqimi të programeve të mëparshme elektorale, pra për zgjedhjet në ndihmë të kujdesit të votuesve. Duke u ndalur në këtë pikë, Presidenti i Klubit Shqiptar të Medias Shkëlqim Bylykbashi foli për një anketim që kishte bërë duke nxjerrë nga arkiva kasetat me premtime para zgjedhjeve lokale 2003 duke i ballafaquar me një periudhë të caktuar post-

zgjedhesh dhe me premtimet e pambajtura, e cila u pat pritur shumë mirë nga publiku. Lektorët kanë vijuar pastaj me zgjidhjen me profesionalisëm të situatave të ndryshme të komplikuar në të cilave mund të ndodhet një gazetar në periudhë zgjedhesh e jo vetëm.

Në mbyllje Presidenti i Klubit Shqiptar të Medias Shkëlqim Bylykbashi i ftoi gazetarët e pranishëm që të propozonin tema të tjera për bashkëpunime të frytshme në të ardhmen. Përfaqësuesi i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë në Shkodër sugjeroi zhvillimin e seminareve të ngjashëm të destinuar për gazetarinë investigative duke argumentuar këtë kërkesë me nevojën e pavarësisë profesionale dhe ekonomike të gazetarëve në këtë periudhë ku po ngushtohen dita ditës hapësirat e fjalës së lirë. Ky propozim u prit mirë dhe drejtuesit e Klubit Shqiptar të Medias u shprehën të bindur se do të riktheheshin në një të ardhme të afërt në Shkodër me ndonjë aktivitet të ngjashëm me ta.

Nga ARBEN LAGRETA

ku po rrinin, duket për të mposhtur dhimbjen që ndjen. Ishim vëllezër, por ishim edhe shumë shokë -thotë Frani, duket se nuk flet goja por zemra. Ndreka ka punuar kumpanjelin e Kishës së Fretërve në Shkodër nga fillimi e deri në fund, -ndërhynë Zefi, ishte edhe ai mjeshtër shumë i mirë në punimet me gurë.

Ai ka lënë shtëpinë plot, se ka gruan, dy djem dhe tri vajza, të cilët punojnë e jetojnë mjaft mirë, por pa Ndreken. Nuk e kishte moshën për tu larguar nga kjo botë, por zoti i di më mirë këto punë - shprehet Frani.

NGA NJËRI OBJEKT NË TJETRIN, SECILI MË I BUKUR ...

Pas 9 vjet punë në Itali jam kthyer në Shqipëri dhe kemi filluar punën me gurin këtu.

Në një kënd të oborrit, pak metra larg shtëpisë së Franit, është një vend puna që tashme nuk mund të quhet punishte e thjeshtë. Aty ka makineri, ka gurë, ka punime guri që nga pllakat e gurit për shtrim apo për veshje muresh, por edhe mjete të tjera që mund të përdoren si zbulurime apo mjete pune në shtëpi apo lokale si tavolina të llojeve të ndryshme, vazo lulesh e të tjera. Këtu nuk flitet më me kuintal. Flitet gjithmonë vetëm me ton ose metër kub. Ka makineri që mund të përpunojnë gurin njëherësh deri 30 ton.

Në një ditë nuk është e mundur që të shëtitësh vendet krye-

sore ku dora e Franit, Sokolit dhe Sandrit kanë punuar. Gjithsesi ne i vizituam me shumë kureshtje dhe kënaqësi për disa ditë. Me makinën e Sokolit lëvizim. Ku po ja fillojmë, thotë Sokoli. Ne nuk dinim nga ta fillonim dhe në këtë moment ndërhyr Franit. Po shkojmë në Tiranë në fillim pastaj ditët e tjera shkojmë edhe në vende të tjera.

Arritëm në Tiranë dhe ndalemi përpara Kishës ku ka qendrën Radio Maria. Bukuri mahnitëse, kulturë dhe estetikë kudo. Dora e mjeshtërve të gurit ka bërë gjëra që na mahnitën, secila më e bukur se tjetra.

Në ditë tjera vizituam edhe objekte të tjera. Një ndër to që Kishën e Pentarit. Këtu të bien në sy shumë gjëra të mira, por gdhendja e Shën Mhillit mbi shejtanin dhe altari janë një art i vërtetë. Nga guri një cope janë gdhendur me shumë durim, me kujdes dhe përkushtim. Ato duken se të flasin, të rrëmbejnë dhe të bëjnë për vete. E pastaj kalojmë në Rranza të Bushatit, përsëri në kishën e fshatit, rrethimin e Kishës së Shënkollit në Shkodër, Shkollën "Neki Lezha" në Shkodër, bar "Fontana", rrethim oborri në një shtëpi banimi në Bardhaj, punime në shtëpi tur-

istike në Razëm, zbulurime në kalanë "Iliria" me disa objekte si tavolina komplet guri, vazo lulesh të madhësive dhe formave të ndryshme apo harqe



dyersh, por e veçanta e punimeve në kështjellen "Iliria" është ariu. Ai është i vendosur në një vend të dukshëm dhe sikur të flet, të përshëndet, të uron mirëseardhjen në këtë objekt. Na tërheqë shumë, punim me shumë kujdes, gurë i bardhë masiv. Ka qenë një gurë rreth 13 ton -thotë Frani, për ta ardhur deri këtu siç e shohim tash.

NËNË TEREZA, NËNA JONË

Në Shtoj, në të majtë të rrugës që të çon nga Shkodra në Koplík shikohen disa objekte guri të gdhendura me shumë kujdes, me shumë dashuri. Aty ka disa lloje si harqe dyersh, gryka pusi, tavolina të ndryshme, vazo lulesh të formave dhe madhësive të ndryshme, gurë për dyer e dritare, e te tjera. Të bukura, shumë të bukura këto dhe të gjitha ato që pamë më parë, por njëra është e veçantë. Një skulpturë 2.5 metër e lartë, e gjallë, sikur flet me të gjithë ata që e shikojnë, duket gjallërisht që bën lutje për të gjithë njerëzit. Kjo është shtatorja e Nënë Terezës. Na tërheqë shumë puna e bërë, kujdesi që çdo rrudhë e fytyrës së saj të jenë në vendin e duhur, duart të puthitura shumë bukur, palat e rrobave të saj shumë të gjalla dhe harmonike, sikur i shpalosë era edhe në momentin që i shikon, sytë e saj të hedhura diku në thellësi, mendueshëm dhe vendosmërisht në shërbim të njerëzimit. E, edhe këmbët e saj të zathura

mbi disa sandale të thjeshta flasin për thjeshtësinë dhe përvujtshmërinë e saj. Kemi punuar shumë gjatë dhe me shumë kujdes për ta realizuar këtë shtatore, -thotë Frani, por nuk kemi ndjerë lodhje, ajo është "Nëna" jonë. Kohët e fundit u vendos në oborrin e kishës së Hotit.

Mjeshtëria e gurit, si edhe mjeshtria tjetër në male, nuk po shuhet, përkundrazi ato po shtohet me të tillë njerëz, të mirë dhe punëtor. Kjo është mjeshtria, që në shekuj e bënë edhe malësorët tonë me ato mundësi që kishin dhe që u lejonte koha dhe teknologjia. Por nuk është mjeshtria e vogël që pa mjetet e sotme, pa çimento dhe hekur, me një çekiç dhe mistri, me një sitë të bërë shpesh me thupra ahu ose thanë, me një lopatë shpesh edhe druri, me spikun në vend të spangos për të marrë drejtimin, me një plumbçë të thjeshtë e jo radhë të ndërtuar nga një pe leshi e të varur një gurë në fund të tij, ndërtuan shtëpi dy e tre katesh, që i rezistuan shumë gjatë kohës edhe pse në shpate mali mjaft të paqëndrueshme dhe të vështira, ndërtuan harqe urash dhe ura, ndërtuan kështjella, që jetuan me shekuj dhe jetojnë edhe sot.

Këto janë mjeshtria, historia dhe kulturë që ecin dhe duhet të ecin bashkë me njerëzit dashamirës e punëtor dhe që të përcillen nga njëri brez tek tjetri.

Nga Luigj SHYTI

KRYENGRITJA OPOZITARE E SHKODRES - 31 MAJ 1924

**- LUANIN E TOSKNISË (FERIT FRASHRIN) E VRAU LUANI I SHALËS (GJELOSH MARKU)
- DUKAGJINI MORI PROFEKTUREN**

Në pranverë 1924 situata e brendshme politike mes forcave qeveritare dhe te Opozitës demokratike Fanoliste, acerohet akoma më shumë. Nga ana e opozitës pas vrasjes se Avni Rustemit me 5 maj 1924, filloi një punë e gjerë dhe e organizuar për të përgatitur kryengritjen dhe për të bërë për vete ushtrinë. Përgatitjet bëheshin paralel si në Shkodër ashtu edhe në Vlorë. **"Nga Permeti Koço Tasi me 120 vullnetarë, nga Skrapari Riza Cerova me 60 dhe aspirant Xhemal Mandili me 50 veta. Sa për Shkodrën Postriba ka qënë me Zogun, pra vetëm Bajram Hyseni nga Rjollli mori pjesë në Kryengritje për hater të Sulçe beut(njeriu i Sulçe Beut), por jo me influencë mori pjesë në kryengritje me një fuqi prej 300 vetesh. Gjithashtu morën Togër Ndokë Gjeloşi me 200 dukagjinas dhe Dom Loro Caka me 100 malësorë nga Shllaku, ndersa në Vlore kanë marrë pjesë dy kompani me 200 ushtarë"**.¹ Me 13 maj nga qeveria dhanë dorëheqje dy ministrat demokrat, **Luigj Gurakuqi dhe Fahri Reshiti**, duke paraqitur si arsye faktin se qeveria nuk gëzonte më besimin e Asamblesë. Pas tre ditësh, me 16 maj garnizoni i Shkodrës, me komandant Nenkolonel Rexhep Shalën, u shpall kundër qeverisë². Ndërkohë Prefekti Shkodrës Abedin Neprevishta, së bashku me Kryetarin e Bashkisë Musa Juka dhe Qark Komandantin e xhandarmarisë Kapiten Ferid Frashrin, u munduan të luaj me të gjitha kartat për të mbajne situatën nën kontroll. Mblodhën parinë dhe i bënë thirrje popullit të rrëmbente armët për mbrojtjen e rendit nga forcat tradhtare të dezertore të ushtrisë, duke provokuar kështu rrezikun e një vëllavrasje të përmassave të gjera. **Fuqitë e Ushtrisë nën komandën e Nën Kolonel Rexhep Shalës të mbështetur Ndokë Gjeloşi, Vas Kiri, Xhemal Bushati, Dodë, Thana, Xhemal Bushati, Mark Raka morën masa të menjëhershme me një vullnet të fortë e guxim të madh demonstruan hapur vendosmërinë dhe epërsinë tyre që dukej sheshit**. Populli i Shkodrës me shumicë absolutë u solidarizua e me veprimin e ushtrisë dhe te opozitës tek e cila kishte mbështetur gjithë shpresën e vet. **Ditën e shtunë me 31 maj Profekti Neprevishta shpalli një alarm provokues në popull, duke thanë "se do cuba të Dukagjinit po msynin Shkodrën e se Profektura kish da mos me u lëshue"**.³ "Fuqia qeveritare e përberë prej 125 xhandarësh, mbeti me 32 xhandar, gati të gjithë prej jugut. Nga paria e Shkodrës, Postribës, Shkreliit dhe

Grudës së bashku me oficer të ushtrisë Kombëtare bëheshin 42 vetë"⁴. Ky lajm shkaktoi trazim me tepër në qytet pasi se autoritetet po përiqeshin ta mbanin me çdo kush Profekturën në zotërim. Mbas këtij tellalli propagandistik dhe provokues Rexhep Shala në emër te forcave të Garnizonit të Ushtrisë së Shkodrës shpalli gjendjen e Shtet Rrethimit⁵.

Në mbrëmjen e 31 majit përpara se të kërciste pushka u iniciua lëvizja e fundit dhelprake duke tentuar ndezjen e zjarrit të fanatizmit fetarë. Me urdhër të prefektit Abedin Neprevishta e të kryetarit të Bashkisë Musa Juka u mblodhën hoxhallaret në xhaminë e Parrucës, për të biseduar në e lejonte feja apo jo që pushka të kthehej kundër qeverisë. Edhe hoxhallarët e Shkodrës ishin të ndarë në dy grupe: me opozitën edhe me Zogun. Ata që anonin nga Zogu (shumica), përgatitën



këtë thirrje: "Binduni Perëndisë, binduni rresulit (profetit) si dhe sunduesit tuaj" Sigurisht këtë e bënë me qellim që të ndalohej kryengritja e të mos niste pushka kundër qeverisë⁶. Kur e panë se ishte e pa mundur të frenohej revolta hoxhallarët Zogist vëndosen që të hiqej prefekti Abedin Neprevishta e në vend të tij të vihej përkohësisht një hoxhë sigurisht ithtarë i Zogut. Ishte pikërisht momenti kur hoxhallarët po i afroheshin ndërtesës së prefekturës, me urdhër të komandantit të ushtrisë të Shkodrës nisen veprimet ushtarake. Ndrecë Prnga bëri një mësymje kundër Zyrës telegrafike ku ndodhej Luigj Gurakuqi, duke u marrë vesh me

Tiranën⁷, por u detyrua të zbrapset pasi forcat e ushtrisë të shpallura kundër Zogut kishin marrë masa për mbrojtje e Gurakuqit që ishte si shpirti dhe ideatori kryesorë i kësaj lëvizjes së Shkodrës. As veprimet e dëshpëruara të togër Luigj Shantojës nuk artën të frenonte vrullin e lëvizjes që hyri në histori si **"Revolicioni i Qershorit"**

DUKAGJINI KAZERMA E OPOZITËS FANOLISTE

Dihet se disa ditë më përpara në Dukagjin kishte filluar një sulm i shpejtë i malësorëve të Shalës, Shoshit dhe Pulit, Nikaj-Merturit kundër forcave qeveritare të Nënprofekturës së Dukagjinit. Kryengritësit me një sulm të befasishtë morën qendrën e Nënprofekturës në

që të lejoheshin të lirë ja mbathnin nga te donin prej rrethuesve.

Kapiten Ferid Frashëri trim si luan⁸, komandant i xhandarmarisë dhe nuk pranoi që të dorëzohej i gjallë dhe vazhdoi me kokëfortësi qëndresën. Në orën 8 të mbrëmjes filloi luftimi në Prefekturë dhe zgjati gjithë natën dhe nesër nade për 12 orë deri në 8 para dite⁹. Gazeta "IL Progresso" së cilës i referohet "Dielli" i datës 5 qershor 1924 shkruante: Telegramet nga Beogradi thonë se një kryengritje plasi në Shkodër. Dy deputet mbi krye të 2000 kryengritësish u atakuan me forcat e Gravurës. Të dielën në mëngjes pas 24 orë lufte pa pushim kryengritësit zaptuan Shkodrën. Kryengritësit kanë 2000 vetë e 4 topa të malit dhe disa mitraloza, kurse forcat e gravurës nuk numërojnë më shumë se 700 veta të armatosur lehtësisht dhe pa topa. Kryengritësit të shtunën mbrëma nisën të bombardojnë qytetin duke bërë bombardime të gjithë natën dhe veç kundër Prefekturës ku prefekti kishte mblodhë 300 xhandarë për mbrojtje¹⁰. **Rënja e profekturës u shoqërua me 6 të vrarë Kapiten Ferid Frashri Qarkomanati i Xhandarmarisë, 3 xhandarë dhe 2 ushtarë**¹¹.

KOMANDATIN E RRETHIT FERID FRASHERIN E VRAU GJELOSH MARKU

Kush ishte Ferit Frashri

Ishte një oficer karriere (xhandarmarie) i devotshëm vigu bazamentali i pushteti presidencial të Ahmet Zogut në Profekturën e Shkodrës. Në ditët e stuhishme kur ndizej flakë pakënaqësia dhe urrejtja e popullit opozitar, kur Shkodra manifestonte hapur viloencën dhe kërkohesh hapu zaptimi i zyrrave te shteti dhe përzenja nga qyteti i mbështetësve te Ahmet Zogut. Kapiten Ferid Frashri ishte një mburojë statike e që nuk lëvizte vendit por qëndronte me guxim si Taraboshi mes rresbesheve të motit. Camillo Libardi në kujtimet e tija historike Ferit Frashrin e përshkruan si një titan; I tillë ishte gjoksi i Kapitenit të xhandarmarisë së Shkodrës, burrë trim, ushtar me kalitje të fortë, shqiptar i vërtetë i bindur i bindur se përpara së gjithash duhej të kryente detyrën e tij e në asnjë mënyrë të mos hante fjalën e dhënë dhe për një gjë të tillë ishte betuar përpara qeverisë njeriut dorëhekurt të saj. Një fare fis i afërm i Melek Frashrit që kishte lënë kokën në Krugë për Ahmetin, gjë te cilin e beri edhe

4 - Sejfi Vllamsi Ballafaqime politike 1912-1939, fq 258

5 - Ora e Maleve po aty.

6 Revolicioni i Qershorit 1924. Ngjarjet e Shkodrës Halim Shpuza fq 226

7 - "Ora e Maleve" po aty

8 - Sejfi Vllamsi po aty

9 - Ora e Maleve, 12.06.1924.

10 Dielli 5 Qershor 1924

11 Ora e maleve po aty.

1 - Sejfi Vllamsi Ballafaqime politike në Shqipri 1912- 1939, fq 256.

2 -Historia e Shqipërisë Vell i III fq 284

3 - Ora e Maleve, 12.06.1924

Feriti në Shkodër.

Kush ishte Gjelosh Marku

Ishte nga fshati Mekshajt dhe zinte vend nderi në almanakun plis-bardhëve të vjetër të Shalës, i fiksuar ne kujtesën e kohës, si portret interesant, plot hire mashkullore, sy gace mustaqet shllungë me plis të bardhë të rrumbullaket e perçë në but të kokës si dikur motit. I shtërnguar ne kacaturre, gjithmonë heshtur dhe në pozitë nderimi, dokeve stërgjyshore. Trim i pa frikshëm kur e donte puna me ruajtur erzin personal, nderin e krahinës e vatanit. Për fjalën (*dhënë*) që del nga del shpirti vetëm vdekja e anulonte dhe shuante si premtim. Bujarinë e kishte në gjak, tërvësën e shtronte trimërisht deng (*bukë, djathë, mish, venë, raki, tlyen e bulmet*) pasi kishte shtëpinë si mali me dushk e me barë, plot gja e mall të siguruar më djersën e ballit dhe shikën e dorës. Kullës e tij me këvret druni i gëzoheshin trentë mbi shkorsë kur çonte zoti e binte ndonjë mik të njohur e te pa njohur qoftë, shtegtarin qe sillte drumi në shtek të oborrit. I vobekti e lypsari, i kamuni, kryepariket e bajraksit respektoheshin e gostitëshin fort ma mirë se bima shpirtit (*djemtë dhe çikat e tij*)

Gjelosh Marku në ngjarjet me kulmore të fillim shekullit të XX u gjend krah për krah me Mehmet Shpendin, Lush Prelën, Avdi Kolën, Çun Nikën, Marsh Delinë e burra të tjerë të Dukagjinit me 1910 e 1911 kundër turqve dhe 1915 kundër malazezve Ky trim i pae-pur, antizogist i betuar, gjatë klimës së paqëndrueshme politike të viteve njëzet qe mbështetës i forcave të Fan Nolitsi, doli koçak kundër qeverisë, qe protagonist i qëndresës së armatosur kundër forcave qeveritare me 16 maj 1923 në Shkallën e Thethit dhe më pas afër Urës së Shalës. Ai ka qenë një bashkëluftëtarë më të ngushtë Ndokë Gjeloshin, përkrahës i kandidaturës së Luigj Gurakuqit, si përfaqësues i opozitës. Ishte ndër të parët zjarrmëtarë që rrethoi Nënprefekturën e Dukagjinit në mbrëmjen e 29 majit 1924 dhe debimin e autoriteteve qeveritare nga Dukagjini. Marshoi gjithë entuziazëm së bashku me qindra dukagjinat të tjerë përkrahës të opozitës, vihet në mbështetje të forcave të Ushtrisë Kombëtare të komanduara nga Rexhep Shala në sulmin mbi prefekturën e Shkodrës, natën e 31 majit 1924, sulm i furishëm që vazhdoi pa ndër-prerje për plot 12 ore resht.

Me 8 qershor 1924 mori pjesë perberje te detashmenteve vullnetare të Ndokë Gjeloshit e Vas Kirit ne sektorin Gjader Kodrat e Lezhës mbi forcat qeveritare të Nënprefekturës Lezhë, aksion që zgjati 4 orë ku pati 13 të vdekur e 6 të plagosur. Pas pushtimit të Lezhës sipas urdhrit të Komandës se veprimeve luftarake u stacionua së bashku me vullnetaret e therë duke pritur veprimet e mëtejshme të Pararajës Ushtrisë Kombëtare nën komanden e Ndokë Gjeloshit e cila hyri në mënyrë spektakolare në Tiranë. Gjatë këtij inkursioni ndërtej Miloti mbeti vrarë

edhe Kolë Sejdia i Shalës.¹²

FAKTI: VRASJA FERIT FRASHRIT

Gjelosh Marku u pozicionua me disa shokë të vet malësor kryengritës kishte zënë pritë tek një shtëpi që ndodhej përpara prefekturës duke vjedhur zjarr pa pushuar qëndroi aty përgjatë gjithë natës deri sa një plumbi manxerres se Gjelosh Markut qëllloi ne kokë luanin toskërisë Ferit Frashrin, i cili (*sipas kujtimeve te bashkëkohësve*) kishte vendosur edhe në qoftë se nuk e çante dot rrethimin me ata 30 xhandarë që i kishin mbetur nga jugu t'i vinte flakën profekturës me anën e benzinës. Kapiteni për ketë qellim kishte grumbulluar ne disa bidona, duke menduar të vdiste si Oso Kuka¹³. Gjelosh Marku kishte punuar për disa muaj xhandar në Shkodër, ne zgjedhjet elektorale te vitit 1923 i nxitur nga Ndokë Gjeloshi u pozicionua të tij përkrah Gurakuqit dhe opozitës duke u larguar përfundimisht nga arma e xhandarmarisë. Ai e nihte madje e çmonte shumë karakterin dhe vendosmërinë e ish komandantit të vet. Kur ra nata Ndokë Gjeloshi gjatë kontrollit të pritave i pati thënë:- Gjelosh Markut, se Ferit Frashri nuk e din se çfarë është tuta dhe nuk dorëzohet kurrë për së gjalli. Mos harxho fishekë kot mbi te



tjetër kënd, pasi pa vra Feritin nuk e marrim profekturën. Ti je personi i vetëm në ketë pritë qe njeh Komandantin prandaj mundohu me syzue po ta kapi syri. Pas bataresh të gjata e pauzash taktike te herëpashershme, për fatin e tij tragjik. Komandati zemërzjarrtë kur nxori kokën në një frëngji duke u dhënë zemër besnikve të tij te mbetur në zgrip pa fishekë e të ngjuar në zjarr e breshëri mash-nash, pikaset nga një shigjete vrastare e Gjelosh Markut, e cila shembi pa jetë luanin e toskrisë. Ferit që vdiq si i ka hije një legjionari të lavdishëm të shtetit.

¹² Camillo Libardi "Si u be mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu". Kujtime historike, Tir bot i vitit. 2012, fq.35

¹³ Sejfi Vllamsi Ballafaqime politike 1912-1939, fq 365(sipas kujtimeve te Sadi Zekës)

Vetëm pas pak çastesh më pas trupa e mbrojtëse e dërmuar dhe mbetur pa mburojë. pa kokë ngre flamurin e bardhë të dorëzimit.

Ferit Frashri hyri në historinë e Shkodrës si shtylla monolite e qëndresës Zogiste, ndërsa Gjelosh Marku si rrufeja vrastare, që vulosi përfundimisht rënien e Rozafës në duart e forcave opozitare

GJELOSH MARKU NË KUJTIME E LIBARDIT!

...Ndokë Gjeloshi me disa pasues te tij dhanë shenjën e alarmit dhe pas mbërritjes së forcave të mjaftueshme filluan sulmin mbi prefekturën, aty ku ishte luani. Gjeja e parë që bënë me shumë dinakëri pushtuan pusin. Lufta zgjati gjithë natën. Të nesërmen kur Ferit dhe të besuarit tij ishin të lodhu e ndërkoh u ishte mbaruar gjithë municionet, u kacavirren nga ana e prapme e pallatit të prefekturës nga ku shihej një kopsht. Gjelosh Marku nga Mekshajt e Shalës me të tjerët e të njëjtit fis, kishte ndryshuar pozicionin dhe kishte zënë vend prapa prefekturës. Nga poshtë u dëgjua një shtënë, e cila u ndoq nga një britmë e mbytur dhe renkime. Heroin (Gjeloshi) e kishte goditur në kokë dhe ra siç bijen të fortët. Kaluan disa mintua me një qetësi të tmerrshme. Pas pak një flamur i bardhë nga një dritare i mbajtur nga të besuarit e tij. Profektura u morë, Partia e Zogut dukej e plagosur për vdekje¹⁴. Gjelosh Markun e paten arrestuar forcat e Muharrem Bajraktarit se bashku me Lekë Vuksanin ku i morën të lidhur me zinxhir (*rebeli i lidhur me duar prapa me hekura nemcje te vidosura deri në zero, nga rrugen nga Shala në Shkodër e beri në këmbë dhe nuk u lejua as të hante buke as te pinte ujë as të pinte duhan ndonëse i dridhej biza per nje cigarenëvizimi im P.M*) Gjeloshi kur mbrini Muharrem Bajraktari në Shalë u arratis neper pyje e neper male. Pastaj duke u besuar fjalëve të bukura të Ndue Sadikut (Pecaj), krah i djathtë dhe këshilltar i Muharremit vendosi të dorëzohej e të mos jetonte malit si bishe te rrezikonte jetën e familjes Pasi u dërgua në Burgun e Shkodrës gjyqi special politik e dënoj si nxitës dhe pjesëtarë i revoltës së armatosur për përmbyshjen e rrëgjimit kushtetues, si kriminel me duar të përgjakura dhe

vrasësi i Komandantit të Qarkut Shkodër Kapiten Ferit Frashri. Vlen te theksohet qëndrimi shumë fisnik i Gjelosh Markut në Gjyqë kur u pyet nga Kryetari i seancës se kush e vrau Ferit Frashrin. Së pari Lek Vuksanin mos e përzieni në këtë punë e mos e merri në qafe pa pikë fajit. Ferit Frashrin ne se plumbi e ka marrë në kokë me qatë plumb e kam shytue unë. **Ferit Frashi nuk është një burrë me shkua gjak hupur. Nëse duhet të përgjigjet kush për vdekjen e tij qe ku më ken. Unë e vrava ishim në lufte, në luftë nuk shkohet me u puthë por me u gjuajtur me plumba. Pushka të vret por nderon burrin. Qe ku me kini jam dorëzua ne besën tuaj**

¹⁴ Camillo Libardi "Si u be mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu". Kujtime historike, Tir bot i vitit 2012, fq.35.

dhe nuk kërkoj mëshire, pasi çdo gja e kam ba me dëshirë kundër këtij regjimi të mallkuar, ndërsa me Ferit Frashrin nuk kam patur as gjë personale por siç e thash kemi qene ne dy llogore kundërshtare luftimi (inenvizimi im PM). U dënua me vdekje varje ne litar nuk iu mohua prania e priftit, që quhej At Giuseppe Lochman O.F.M kam. **Vdiq me ndjenja të krishtera, iku nga kjo botë si hero. Nuk u tremb dhe fytyra e tij nuk pati as një shenjë frike vra, u var në litar, aty tek "Fusha e druve"**¹⁵. Varja u bë publike me tellall, viganin e therrorizuar e lanë gjithë paraditen varur për t'i shti tmerrin njerëzisë. Trupi i tij u gropos në Shkodër dhe nuk u lejua që ta merrnin familjaret. Në Shalë shungulloj gjama e burrave te moti sa drithëroj gjithë bjeshkët, gjamë ku morën pjesë gjitha fiset e Dukagjinit .Vajtoret qanë me kujë dhe derdhen lot pikëllimi mbi rrobat që vishte kur shkonte ne festa e krushqi, martiri posi në ditën e lamtumirë nga kjo jetë prehej diku në një gropë të zezë i ndëshkuar si heretik i regjimit të Ahmet Beut e tradhtar i atdheut.

KUJTIMET E BASHKËLUFTËTARVE

Sipas kujtimeve të Mark Milanit, Babun Celit, Zef Delisë, Martin Marashit, Pal Mhehilli pjesëmarrës në atë rrethim, konfirmohet se Gjelosh Marku ka qenë në një pritë me këta kryengritës kur ka qëlluar nga pozicioni pas prefekturës përballë, për ballë dritares ku nxjerri kokën Komandanti i Qarkut. Ajo që është artikulluar në mënyrë të qartë nga gjithë ky grup dhe ka mbetur i fiksuar ne kujtesën e kohës është se Gjelosh Marku pas kësaj të shtëne tha:- **Kaq e pati komandanti jem!** Pastaj mori një shami të kuqe dhe e lidhi në tytën e pushkës si shenjë i triumfi te merituar, duke treguar simbolikisht para gjithë rrethueseve : **"se unë e vrava Ferdi Frashrin"**¹⁶ pohim që do t'i kushtonte kokën menjëherë pas rikthimit të Zogut në fron..

Lidhur me këtë ngjarje Gazeta e përditshme "Tomori" e datës 6 tetor 1931 e pakënaqur nga masa e dënimit që mori N.Gjeloshi në gjyqin e Riedit në Austri nuk nguronte ta quante krtë si kriminel me duar të përgjakura duke sjellë në kujtesë edhe rastin e Gjelosh Marku që akuzua për vrasjen e Ferid Frashërit.

Gjelosh Marku u flijua në mënyrë biblike për idealet, opozitës Fanoliste që përfaqësonte fytyrën dhe korrentin më të pikasur perëndimor të shoqërisë shqiptare. Si patriot i sprovuar dhe martir idealeve progresive të kohës së tij ka, hyrë në mënyrë më shembullore në historinë shembullore te Dukagjinit dhe të Shkodrës. Emri i Gjelosh Markut dotë jetojë aq sa kambi ynë është i pranishëm në këngët e popullit

Prelë Milani

¹⁵ Camillo Libardi "Si u be mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu". Kujtime historike, Tir bot i vitit 63, fq.

¹⁶ - Treguar nga Bal Mark Milani Marsh Babuni, Lazer Pali, Dedë Binaku sipas kujtimeve te eterve te tyre Mark Milani Babun Celi, Pal Mehilli. Binak Pjetra pjesmarrës në ate rrethim, përkrah Gjelosh Markut, nën komanden e Ndokë Gjeloshit.

Dod Tahiri, kreshniku i portës Shqiptare

Në kuadrin e 10 vjetorit të Krijimit të saj, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", në bashkëpunim me Klubin Sportiv të futbollit "Vllaznia", me propozim të drejtorit

min "Loro Boriçi" për nder të Portierit të parë të Kombëtares së Shqipërisë, 2 herë Kampion i Vllaznisë, Kampion i Ballkanit, portier i Kombëtares së Malit të Zi, Ceti-

skadrës së futbollit "Vllaznia", që Doda i fali gjithçka, "Partizanit" historik dhe "ADA" simpatike.

Rezultatet ishin: ADA-PARTIZANI 2-1 dhe ADA-VLLAZNIA 1-0 FITUESE ADA

Vlen të përmendet shpirti i garës që dhanë futbollistët në fushën e blertë e në veçanti ekipi "ADA", e cila duke pasur rastin të luante dy ndeshje holli në fushë edhe futbollistët e rijtë, të cilët premtojnë për një të ardhme edhe më të mirë

Shkodrës, motrës së Dode Tahirit, Zoja Mrisha, ja dorëzoi kryetari i Këshillit Bashkiak Shkodër, av. Badhy Lohja. Ky turne ishte në një moment, i cili të gjithë të pranishmëve na dha emocione që buronin nga puna dhe djersa e të madhit Dod Tahiri. Ai, është shembull i mirë për futbollistët e sotëm, por edhe për të gjithë ne. Jeta e tij na mëson të gjithëve se, me dashuri dhe këmbëngulje realizohen ëndrrat, ato bëhen realitet.



Skadrat e futbollit "Vllaznia" e "ADA"



Kryetari i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", duke dorëzuar Kupen "Dode Tahiri", kapitenit të ekipit "ADA", që fitoi kete kupe



Kryetari i Keshillit te Bashkise Shkodër, av. Bardhy Lohja, duke i dorëzuar titullin "Mirënjohja" e qytetit, dhene portierit te madh Dode Tahirit, motres se tij, Zoja Mrisha

teknik të këtij klubi (ish portierit kampion), Armir Grima dhe nën përkujdesjen direkte të Presidentit të Klubit të futbollit "Vllaznia", Agron Çela, ditën e Martë, datë 07. 05. 2013 në ora 17.00, në Stadiu-

nës, Budeçnostit dhe Hajdukut; fenomenit që pësoi vetëm 5 gola në dy kampionate kombëtare, Mjeshtër të Merituar të Sportit **Dodë Tahiri**, u zhvillua turneu për nder të emrit të tij, me pjesëmarrjen e

dhe shpresojmë që së shpejti ato të na nderojnë duke u bërë pjesë e supërligës.

Në përfundim të ndeshjeve, Kupën e këtij turneu, kapitenit të ekipit "ADA", ja dorëzoi Kryetari i shoqatës, Ndue Sanaj. Ndërsa titulli "MIRËNJOHJA" e qytetit te

Në përfundim i falënderojmë të gjithë, të cilët mundësuan këtë turne duke i uruar Shkodrës që aktivitetet të tilla, në promovimin e vlerave të bijve të saj, të ketë sa më shumë.

Nga Roza Pjetri

NDOC BJESHKA U BËN LEKSION DUKAGJINASVE ME SY TË SHËNDOSHTË, POR TË VERBUAR POLITIKISHT

Ndoc Bjeshka ka lindur në fshatin Nderlysa të komunës Shale, në vitin 1952.

Që në moshe të re u shqua si prototipi i një sanguini, i shkathet, rebel ndaj pa drejtësive, autoritarizmit të rriturve, anti-konformist, inteligjent, me histori spektakolare aventurash feminare e djaloshare. Në vendlindje përfundoi shkollën tetëvjeçare, pastaj largohet, duke filluar kalvarin shëtitës ndërmarrje në ndërmarrje, kantier në kantier, vishej bukur, mbahej pastër, adhuronte gotën e bredhë pas fustaneve.

Në vitin 1971 përfundon shkollën e mesme, me 1972 mobilizohet në shërbimin e detyruar ushtarak, në Jug të Shqipërisë, në një repart xhenier pasi kishte biografi të pa pastër politike. Gjate shërbimit ushtarak, në vitin 1973 humbet shikimin, në lulen më të bukur të rinisë, por nuk dorëzohet, me optimizëm dhe forcen e karakterit që e karakterizonte, arriti të munde Galjadhin, që i verboi dritën e syve. Punon, shëtitë, argëtohet, krijon familjen e tij, rrite e edukon fëmijë. Në lufte dhemb për dhemb me fatin e pa mëshirshëm, në lufte me mentalitet arkaik, sfidon mbartësit e opinioneve bajate, si: i shkreti, qqqari, aventurieri, gënjeshitari (se shef por rrene) dhe krijon portretin e vet sa kompleks aq edhe interesat e bujar.

Mbështet dhe kontribuon për Lëvizjen demokratike në vitet nëntëdhjetë, me guxim e praktikizëm, merr iniciativa private në fushën tregtisë me pakice, si koleksionist i objekteve antike, aktivizohet në veprimtari kulturore, artistike, sportive, shpallet Kampion Nacional për të verbër në Shqipëri, madje ballafaq-



het edhe në sfida ndërnacionale duke u shpallur nen-kampion i Ballkanit për të verbër. Që nga viti 1992 zgjidhet Kryetari i Shoqatës të Verbërve Dega Shkodër, dege të cilën e drejton për tete vite, ndërsa që nga viti 2000 është President i Shoqatës "Shpresa Katolike" Shqiptare i të verbërve.

Në vitin 2005 realizon një tjetër sfidë të madhe jetësore, boton librin e pare me përshtypje autobiografike "Në drite, në terr dhe në tmerr", që pasohet me botimin e dhimbshëm "Engjëjt e Dedit Jon", kushtuar tragjedisë së 9 janarit të vitit 2004, në të cilin humbi djalin e vetëm, Kreshnikun. Ndoc Bjeshka ecën me kohen, vrapon pas suksesit, eksperimenton madje dhe në fushën e minuar të politikës. Nuk dorëzohet edhe kur rrezohet, madje ngrihet dhe vijon përsëri maratonën. Ndoc Bjeshka duhet përgëzuar për kurajën që ka treguar duke u futet për të dytën here në një fushatë të pa mëshirshme e të pa moralshme elektorale, kandidat për në Kuvendin e Shqipërisë. Në zgjedhjet e 23 qershorit kandidon, i pari në listën e Qarkut Shkodër për P. P. "Pensionistëve" të Shqipërisë, duke marrë përsipër riskun e vështirë të zëdhënësit të interesave të invalidëve dhe pensionistëve, që janë shtresat sociale më të pa mbrojtura dhe më në nevojë të shoqërisë sonë, të cilave u premtan

se do luftoje fuqimisht për rritjen 35-40% të pensioneve, sigurimin e Kartës së Pensionistit, rimbursimin e Ilaçeve, arsimimin, riintegrimin dhe punësimin e tyre. Ndoc Bjeshka duke kandiduar për këto shtresa sociale sfidon politiken e të fortëve dhe ecën paralel me vendet më të përparuara evropiane, që këto shtresa kane deputetet e tyre në parlament, madje edhe ministrat e tyre. Ndoc Bjeshka duke kandiduar i pari në listën e një partie në Qarkun e Shkodrës, i jep një shuplake të fuqishme dy parive të mëdha, të cilat në këtë qark nuk kandiduan as një dukagjinat në mesin e larte të listës, por poshtë nr. 10-te, u lëshon një kushtim të fuqishëm intelektualëve dukagjinat që të luftojnë për përfaqësimin politik të komunitetit të tyre se, historia nuk do ua fali një turp të tille. Ndoc Bjeshka u bën një leksion të mire, gjithë dukagjinatve me sy të shëndoshtë, por të verbuar politikisht duke u thënë: "Unë nuk kam sy me pa, por kam dritën e mendjes dhe shpirtit për të pare më mire se ju". Ndoc Bjeshka, mikun e tij, Armir Grima kandidat i PD-se, e ironizon në mënyrë proverbiale duke i thënë: "Ti gjithmonë ke luajtur me Nr 1, po tani çfarë bë që luan me Nr 11!". Ndoc Bjeshka, është pjesëtare i koalicionit të djathtë. PD-ja në Dukagjin ka 20 vjet që merr vota me tonelata. Edhe militanti më fanatik i djathtë duhet ta di se, as një vote për Ndoc Bjeshkën nuk shkon dem. Dukagjinatit e djathtë, të verbrit e djathtë, pensionistët e djathtë, paraplegjikët e djathtë kane detyrim moral të votojnë, birin e tyre dhe përfaqësuesin e shtresës së tyre, në radhe të pare të manifestuar integritetin e tyre.

Nga korrespondenti "Dukagjini"

“Papa Klementi XI dhe familja Albani”, konferencë shkencore në Universitetin “Luigj Gurakuqi”

Qendra e Studimeve Albanologjike organizoi, me 22 maj 2013, në sallën e konferencave të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të qytetit të Shkodrës, konferencën shkencore me temë “Papa Klementi XI dhe familja Albani”. Kjo konferencë u zhvillua përpara një auditori të zgjedhur me profesorë të gradave të ndryshme shkencore, pedagogë, intelektualë, përfaqësues klerik, të qeverisjes vendore, Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, Gjergj Leqeja; Prof. Dr. Eqrem Elezaj, autori i një monografie mbi këtë argument; Prof. Richard Potz, nga Universiteti i Vjenës; Rektori i Universitetit të Shkodrës, Prof. Dr. Artan Haxhi, si dhe Prof. Dr. Ardian Marashi, drejtor i Qendra e Studimeve Albanologjike. Konferencës në fjalë i parapriu një ekspozitë me riprodhime gravurash të epokës, e hapur në mjediset e universitetit të Shkodrës, në të cilën pasqyroheshin disa prej etapave më kryesore të historisë të shumë viteve më parë, dhe më konkretisht të familjes Albani, që i përket edhe Papa Klementi XI.

“Njihemi me një nga figurat e mëdha evropiane dhe botërore, me një familje të madhe që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në kulturën italiane dhe evropiane. Kontributi i tyre qëndron në fakt në themelet e kulturës evropiane, me familjen Albani. Dhe njëkohësisht njihemi me një figurë të jashtëzakonshme, me një Papë, Papa Klementin XI, Albanët”, tha gjatë fjalës së tij, drejtor i Qendra e Studimeve Albanologjike, Ardian Marashi, njëkohësisht edhe organizator i aktivitetit duke vënë në dukje se kësaj njohjeje i ndihmon konferenca e sotme, dhe sidomos fjalët e profesorit, Eqrem Zenelaj, i cili është autor i një monografie, kushtuar Papës Albani, e botuar në Prishtinë përpara tre vitesh. Një botim ky që sipas Marashit, që falë interesimit të madh që ka pasur, të gjitha kopjet kanë mbaruar, ndërkohë që shpresohet që të ribotohet një punim të përmirësuar brenda këtij viti nëpërmjet Qendrës së Studimeve Albanologjike të Tiranës.

Duke folur për autorin e këtij botimi shumë të rëndësishëm që hedh dritë mbi historinë e figurave të Shqipërisë, drejtori

i qendrës albanologjike, Marashi, tha se Zenelaj, ka pasur fatin të rritet në liri në shtetin e Austrisë, në Vjene, ku ka pasur fatin të doktorojë dy doktoratura, dhe ku ka ndjerë të lindë pasioni i madh për arkiva. “Nëse kujtoni, në prag të kremtimit të 100 vjetorit të Pavarësisë, profesor Zenelaj, nxori një dokument shumë të rëndësishëm që lidhet me Shpalljen e Pavarësisë dhe që lidhet me momentin, rrethanat e shpalljes së Pavarësisë”, theksoi Marashi. Më pas duke vijuar të flasë për aktivitetin e Zenelajt, Ai shtoi se, pastaj, profesor Zenelaj, promovoi më vonë në Tiranë një libër me shumë interes, “Historia e Diplomacisë”, moment që ka pasur rastin që të njihet me të dhe të kuptojë që ai ka edhe shumë e shumë materiale të tjera për të nxjerrë në dritë, një ndër të cilat materialet që lidhen me figurën e Papës Klementi i XI, Albani të shoqëruar edhe me riprodhime gravurash të epokës, të punuara posaçërisht në Austri dhe që janë ekspozuar në ekspozitën e hapur në qytetin e Shkodrës.

Duke folur për familjen në fjalë, Marashi tha se kjo familje e larguar nga Shqipëria rreth shekullit XVI dhe vetëm pas 100 vjetësh arrin të zërë një ndër vendet bazë në kulturën italiane. Sipas tij, kjo familje po të kishte qëndruar në Shqipëri dhe po qese Shqipëria nuk do të kishte kaluar atë pushim të gjatë që kaloi. “Normalisht, ashtu si Barleti që e tregoi veten dhe shumë të tjerë që e kanë treguar veten, situata do të kishte qenë krejt tjetër dhe Shqipëria nuk do të kishte qenë tani, të paktën në këtë moment, në pritje për tu integruar në Evropë, Shqipëria do të kishte qenë në Evropë me të gjitha atributet e qytetërimin të kulturës dhe të realizimeve”, tha

Marashi gjatë fjalës së tij. Megjithatë, ai vijoi, “... jemi në këtë stad që jemi sot, dhe ky stad mua më duket e pafalshme ngandonjëherë, është nevoja e jonë e brend-

unë them se ky takim i sotëm, ndihmon sadopak, jo thjeshtë në ndërgjegjësimin tonë për vlerat jetësore që ka nxjerrë nacionaliteti i ynë, por njëkohësisht edhe në atë gradë, në atë shkallë dinjiteti që na jep kjo histori e gjallë, kjo histori e madhe e Papës Klementi XI dhe e familjes Albani. Veçojmë këtu kontributin e jashtëzakonshëm nga larg të papës Klementi i XI. Ai nuk lidhet me ne, me Shqipërinë, me shqipen, me shqiptarët, vetëm prej origjinës, ai lidhet me veprat, me atë çfarë ai ka bërë për Shqipërinë dhe shqiptarët në kohën e tij dhe në kushtet e pushtimit turk.”

Në vazhdim, diskutuan dhe tjerë, duke përcjellë materialet e përgatitura prej tyre, theksuan se kjo familje me origjinë shqiptare nxori, përveç Papës Klementi XI, edhe kardinalë, profesorë, juriste dhe artiste me famë botërore, si dhe ia trashëgimi në muzeun e mirënjohur të artit “Pallati Albani”. Vete Papa Klementi XI nxiti mbajtjen e Kuvendit të Arbrit me 1703, botimin e akteve të këtij Kuvendi, si dhe botimin e Gramatikës së Shqipërisë dhe të serisë historike “Illyricum Sacrum”.

Vetë autori i monografisë, Eqrem Zenelaj, duke folur për vitet e shumta që i është dashur të studiojë dhe të mbledhë materialet për këtë figurë, tha se krahas tij, kanë bërë kërkime dhe kanë shkruar edhe autorë shqiptarë të njohur si At Vinçens Malaj, Imzot Pjetër Koliqi, Engjëll Sedaj, Rexhep Ismajli, e të tjerë. Por, megjithatë, sipas tij, deri më

sot, vetëm ai ka arritur t’i lidhë hulumtimet rreth figurës së Papës Klementi XI, me kërkimet arkivore e ikonografike sistemore rreth familjes Albani, duke u dokumentuar gjerësisht për origjinën shqiptare të kësaj familjeje të shquar, e cila i ka dhënë aq shumë qytetërimin evropian dhe atij botëror, por në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe botës shqiptare.

Nga **Gasper Marku**
gazetar i ATSH-se



Prof. Dr. Ardian Marashi,
Drejtori i Qendres se Studimeve Albanologjike ne Tirane



Prof. Dr. Eqrem Zenelaj

shme për t’i njohur figurat e historisë së nacionalitetit tone, për t’i njohur ngjarjet e mëdha të historisë së popullit tone dhe për të arritur që të reflektojmë personalisht dhe në mënyrë dinjitoze rreth tyre”.

Në vlerësim të kësaj figure, Marashi shtoi: “Ju them sinqerisht që ngandonjëherë, njeriu ndjen dhimbje që figura të tilla si ajo e Papës Klementi XI, Albani janë relativisht pak të njohura ose aspak të njohura në Shqipëri për kontributin e tyre për atë çfarë ato përfaqësojnë. Ndaj,

Manifestimi Tradicional “Zëri i Vëllazërisë 2013”

(vijon nga faqe 3)

Luftëtari i lirisë dhe veprimtari, Avdyll Mushkolaj i ka treguar babait të dëshmorëve se, Manifestimi Tradicional bashkon në aktivitete trojet etnike dhe çdo vit vizitojnë Glogjanin në lartësim të kujtimit për dëshmorët, që janë pjesë e lavdishme e faqeve të historisë sonë nacionale. Pas këtij aktiviteti përkujtues pjesëmarrësit janë gjetur në Deçan për të bashkëbiseduar lirshëm e këmbyer dhurata në trevesen e shtruar vëllazërore nga

kryetari i Deçanit, Rasim Selmaj.

Selmanaj ka lavdëruar këto angazhime dhe ka shprehur dëshirën që me takim të tilla vëllazërore të vazhdohet sot e gjithmonë. Rrahman Jasharaj, Koordinator i Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” ka falënderuar komunat e Pejës, Istogut, Klinës e Deçanit për përkrahjen që po i bëjnë Manifestimit. Ai ka kujtuar se kishte edhe momente të vështira në etapën e përgatitjes së Manifestimit dhe ka falënderuar për ndihmën modeste, por shumë

domethënëse edhe Fatmir Gacaferrin, Ali Shabanin, Bakir Burrin, Ymer Ymerin e Frashër Rracin.

“Komunat na kishin ofruar përkrahjen dhe me ta po jemi më të fortë, por erdhi momenti i tillë sivjet, që edhe përkundër përkrahjes së tyre e brenda mundësive që kanë, po të mos ishte ndihma e këtyre njerëzve të vullnetit të mirë, ndihmë kjo modeste, por shumë me vlerë, Manifestimi do të vinte në pikëpyetje”, ka thënë në përmbyllje të Manifestimit, koordinatori e zëdhënësi i Shoqatës, Jasharaj.

Pjesëmarrësit e Manifestimit kanë bërë gjatë gjithë festës foto e xhirime, të cilat do t’i publikojnë, ruajnë e këmbejnë me njëri-tjetrin. Manifestimi edhe këtë vit, edhe pse ndeshi në shumë vështirësi, ishte madhështor dhe ia arriti qëllimit sepse bëri në një valë, në një këngë e në një trevesë vëllazërit e motrat nga trojet etnike. Ai ishte dhe mbeti zë i Malësisë e për Malësinë.

Nga **Rrahman Jasharaj**

JOKIQËT NGA VELIKA

PJESE NGA LIBRI "JOKIQËT NGA VELIKA", TË AUTORËVE: BRANKO JOKIQ, MARKO JOKIQ, BOTUESI GRAFO CRNA GORA, PODGORICË, NË VITIN 2012

Paraardhësi i Jokiqëve të Velikës është i biri i Çerës, Joka. Çera është shpërngulur nga Shala (Shqipëria Veriore) pasi që popullsia e Velikës mesjetare, e cila ka qenë metoh (pronë) e manastirit të Deçanit, e ka lëshuar plotësisht këtë fshat, në shpërnguljen e Velikës, në vitet 1689-1690, të cilën e ka organizuar patriku serb Arsenije III Çarnojeviq.

Megjithëse nuk ka të dhëna të shkruara precize, se kur ka filluar popullimi i ri i Velikës, gjegjësisht kur ka ardhur Çera, i cili është i pari i fisit dhe shaljanëve të tjerë të Velikës. Sipas të dhënave gojore, është vendosur këtu para vëllazërive që kanë ardhur nga anë të ndryshme të Malit të Zi (Cekliina, Zhupa, Piperi, Palabardhi dhe Vasojeviqët).

Duke krahasuar të dhënat gojore si dhe burimet historike të çfarëdoshme, supozimi dominues është se Çera në Velikë ka ardhur diku mes viteve 1700 dhe 1720. Këtë së pari e konstaton popi Bogdan Lalleviq dhe Ivan Protiq, në Shtojcën vëllimore Vasojeviqët në kufirin malazez, e cila është botuar në Antologjinë etnografike serbe (Beograd, viti 1903). Pohonë se, pas shpërnguljes së lartpërmendur, banorët e rinj të Velikës kanë ardhur nga Mali i Zi i vjetër dhe Vasojeviqët, ndërsa numri më i madh nga Shala. Pastaj sqarohet se shaljanët kanë pasur të parë të fisit Çerën, i cili është vendosur në Ivanpolje (Fusha e Ivanit) dhe nga Zhivaleviqët "ka marrë një farë topalle". Kur ka filluar të punojë në pronën e atjeshme "shkoi tymi nga banesa e tij nëpër të gjithë fshatin, të cilin, duke ecur pas atij tymi, e populluan shtatë djemtë e tij". Këta autorë theksojnë se këtë gojëdhënë (bisedë) e kanë "fituar" nga mësuesi i Velikës Jefto M. Popoviq. Bëhet fjalë, për atë kohë, për një njeri shumë të shkolluar dhe në tërësi të gjithë asaj familjeje Popoviq, ndaj kjo e dhënë është shumëfish e rëndësishme.

Më parë për atë se Popoviqët kanë qenë burim edhe për hulumtimin e dytë të Andrija Joviqeviqit, gjithashtu mësues dhe mbikëqyrës i shkollave, me prejardhje nga Rijeka Crnojeviqa. Sepse, është normale të supozosh se Joviqeviqi edhe më herët, ka kontaktuar me kolegët e vet, e veçanërisht me Jefon, i cili ka qenë jo vetëm mësues në Velikë, por edhe në shërbimin shtetëror ka qenë në pozitë të lartë (Kryetar i Gjykatës së Lartë në Podgoricë, në vitin 1906).

Joviqeviqi në punimin e tij Territori Plavë - Gucisë, Polimlje, Velikë dhe Shekullar, të botuar në vitin 1921, gjithashtu në Antologjinë etnografike serbe, siç shkruan në autobiografinë e vet, sipas udhëzimit të Jovan Cvijiqit, etnologut të dëgjuar serb, themeluesit dhe redaktorit të atij organi të njohur dhe të dëgjuar, ka ardhur në këto vise, me qëllimin që të studiojë të kaluarën, origjinën e banorëve, zakonet e te tjera. Është tjetër çështje (kur është fjala për Velikën) se sa

hollësisht e ka kryer atë detyrim, por në disa shpjegime ka punuar më detajisht se Protiq dhe Lalleviq.

Megjithatë, as ai nuk ka vërtetuar me saktësi se kur ka ardhur Çera. Bashkëbiseduesit i kanë vërtetuar versionin që kanë publikuar autorët paraardhës, duke treguar se kjo ka ndodhur para 200 vitesh, nga çfarë del se Çera është vendosur këtu rreth vitit 1720 (ose diç më herët).

Joviqeviqi shkruan: "Të gjithë shaljanët "depërtojnë" deri tek një farë Çere, i cili në Shalë "ka rënë në gjak" dhe është arratisur kënde, ku më parë është vendosur në fund të fshatit Velikë në Ivan Pole. Çera këtu ka gjetur Zhivalët (Zhivaleviqët) dhe Petroviqët, të cilët, siç duket, janë më të vjetrit. Çera ka qenë katolik, por këtu ka kaluar në ortodoks, është martuar me një vajzë nga Zhivalët dhe me të ka lindur shtatë djem, nga të cilët 4 kanë vdekur pa pasardhës, ndërsa nga tre të mbeturit; Kërta, Joka dhe Ivani e kanë prejardhjen të gjithë shaljanët, që kanë dhjetë vëllazëri me 153 shtëpi. Nga Kërtoja janë Gojkoviqët, Golluboviqët dhe Bërkoviqët; ndërsa nga Golluboviqët është ndarë një degë e vogël: Mikiqët; nga Joka janë Jokiqët nga të cilët janë ndarë Llakiqeviqët; ndërsa nga Ivani janë Radulloviqët, Knezheviqët dhe Simonoviqët; nga Radulloviqët janë Kasumoviqët (si vëllazëri e vogël). Për Kasumoviqët flitet se një grua nga Radulloviqët ka mbetur e vejë dhe është martuar me një muhamedan Garçeviq në Rzhanicën e Poshtme dhe me vete ka marrë edhe djalin e vogël nga Radulloviqët. Këtë djalë e kanë turqizuar dhe e ia kanë venë emrin Kasum. Kur është rritur është kthyer tek vëllezërit, ku Rexhepagiqët i dhanë tokën. Kasumi më vonë, nën ndikimin e vëllezërve të vet është pagëzuar; prej tij janë Kasumoviqët e sotëm. Nga Ivani janë edhe Shaliqët dhe Rakushët në Polimlje. Të gjithë shaljanët janë të lidhur mes vete si të vetët, nuk martohen mes veti, ndihmojnë njeri-tjetrin dhe bëjnë gati gjysmën e vendbanimit të Velikës. Të gjithë festojnë Shën Nikollën e dimrit, por kanë pasur edhe një festim tjetër, me emrin Shën Simeoni (3 shkurt).

Dr. Radosav Veshoviq i përsërit këto konstatime, duke u mbështetur bash në Joviqeviqin. Në librin Fisi i Vasojeviqëve (Sarajevë, 1935) thekson për të kaluarën e Velikës nuk ka regjistrime më të vjetra se statuti i Uroshtit të Tretë si dhe trashëgimi e mbetje të tjera nga e kaluara. Pastaj, kështu e përshkruan Velikën, në vitet 30 të shekullit XX: "Ky vendbanim është mbi fushat e Polimles, nën Çakor, në ultësirën e lumit të vogël me të njëjtin emër me banorët, të cilët nuk janë me origjinë nga amza e fiseve vasojeviqase. Ka 14 fshatra të vegjël, në të dy anët e lumit të Velikës. Duke filluar nga poshtë, majtas janë: Ivan Pole, Përroi i Vukadinit, Desani, Potkraj,

Llazi, Rijeka e djathtë, Volujak, Zakrsh, dhe Bjelice; nga ana e djathtë janë: Shume, Vranpotok, Papratishta (Fieret) e poshtme dhe të epërme, Lijeja Rijeka, rrëzë malit Prijedoll. Në këto vendbanime banojnë rreth 320 familje (shtëpi), me 28 vëllazëri, me origjinë të ndryshme.

Si banorët më të hershëm mendohen të jenë Zhivaleviqët dhe Petroviqët. Disa thonë se ata janë fiset më të vjetra, disa se janë që në lashtësi nga Piperi. Gjithësi ata janë gjetur prej shaljanëve aty kur kanë ardhur para nëntë brezash, sepse sipas gojëdhënës paraardhësi i këtij grupi vëllazërisht (10 vëllazëri shaljanë) ka ardhur në Velikë si i arratisur nga Shala dhe është vendosur tek Zhivaleviqët dhe me që është martuar prej tyre ka pranuar edhe fenë ortodokse (ka qenë katolik). Përndryshe të gjithë banorët e tjerë të Velikës konsiderohen si ardhës të mëvonshëm".

Dr. Mirko Bajraktreviqi (në takimin shkencor në Cetinjë, nga fundi i qershorit 1990, duke sjellë lidhjen e ngushtë të origjinës së Kuçit, Vasojeviqit dhe Piperit (thekson se të gjithë kanë ardhur nga Shqipëria Veriore); për shaljanët e Velikës ka thënë: "Sipas gojëdhënës, para dhjetë brezash ka ikur kënde, nga frika e gjakmarrjes, një farë Çera, katolik, nga fisi shqiptar në veri i Shalës. Në Velikë është martuar nga fisi i banorëve vendas Zhivaleviqëve dhe ka marrë fenë ortodokse. Prej tij më vonë është zhvilluar grupi i gjinive (Bërkoviqët, Gojkoviqët, Golluboviqët, Jokiqët, Knezheviqët, Kasumoviqët, Mikiqët, Llakiqeviqët, Radulloviqët dhe Simonoviqët, të cilët fqinjët i thërrasin me një emër të përbashkët "Shaljanët", të cilët në vitin 1921 kanë qenë më shumë se 150 shtëpi.

Pra, edhe ai si vazhdues i metodologjisë etnografike historike të Cvijiqit, ka përsëritur ato që ka kumtuar Protiq, Lalleviq, Joviqeviqi dhe Veshoviq, gjegjësisht se si bazë e tregimit të tyre ka qenë versioni të cilin, është më e besueshme, në bazë të të thënave e ka hartuar dhe njoftuar i pari Jefto M. Popoviq.

Autorët e sipërpërmendur dhe shkriimet e tyre për shaljanët kryesisht janë më të njohura dhe citohen rregullisht. Megjithatë, ka ende shkrime për eksodin e shaljanëve në këtë anë.

Milosh Velimiroviq në veprën Vasojeviqët dhe Metohia, e cila është krijuar shumë më herët (dorëshkrimi ruhet në arkivin e Akademisë CANU, nr. 1422), precizon se "gjysma e serbëve nga Velika janë me origjinë nga fisi i Berishëve".

Mbi shpërnguljen nga Shala në këto anë dhe në Metohi, të rritur pas migrimit të vitit 1690, shkruan edhe akademiku serb Atanasije Urosheviq në librin "Për Kosovën, qytetet, vendbanimet dhe rregjistrime të tjera antropografike (ribotim Beograd, viti 2010), thekson se "Shqiptarët shaljanë kanë arritur, që atëherë

dhe më vonë (deri te Luftërat Ballkanike) të dëbojnë të gjithë serbët, ose i kanë islamizuar".

Branisllav Nushiqi, nga fundi i shekullit XIX, kur ka qenë konsull në Manastir, ndërsa më vonë edhe në Prishtinë, ka vizituar Shqipërinë Veriore dhe ka shpjeguar arsyet e migrimit: "Shaljanët e Shalës janë fisi më i varfër në të gjithë Shqipërinë". Pastaj, saktësisht konstaton: "Ky ka qenë shkaku kryesor i emigrimit të tyre; dhe janë vendosur edhe në Kosovë (Istiniq tek Deçani, rreth Vuçiternit, ku ka njëzet e pesë fshatra të tyre". Shton se të gjithë kanë pranuar islamizimin, por që festojnë Shën Gjonin (7 korrik).

Në dy vëllimet e librit Kosova (Amza serbe, Novi Sad, 1902), Nushiq ka lënë edhe të dhëna të tjera të rëndësishme për banorët e Shqipërisë Veriore, të cilat më vonë në pjesën më të madhe i kanë censuruar, sigurisht nga që nuk janë përshtatur me interpretimet e mëvonshme të së kaluarës. Mes tjerash, kujton se sundimtarët serbë kanë sunduar në Shkodër gjithsej 150 vite (çfarë asses nuk përshtatet me pohimet bashkëkohore se "Në Shqipëri me shokuj kanë sunduar serbët"). Duhet kujtuar edhe gojëdhënat që edhe sot vazhdojnë për ndjenjat e afërsisë që kanë kultivuar reciprokisht Shaljanët e Velikës dhe banorët e Vermoshtit dhe vendeve të tjera në Shalë. Kur kanë shkuar për në Shkodër, nga ku kanë blerë kripën, duhanin dhe sendet e tjera të nevojshme, shaljanët e Velikës kanë bujtur në fshatrat rreth Vermoshtit dhe kanë qenë pranuar si miq "si të vetët".

Luftëtari Millosh M. Dragoviq (1893-1990), nga Kollashini, në ditarin nga Luftërat Ballkanike shkruan se si Kostadin Mikiq, komandant i batalionit të Velikës, dhe më pas i Brigadës së Vasojeviqëve, kur është kthyer nga luftërat në Shkodër, nga komanda malazeze ka marrë detyrën që të bisedojë me bajraktarin e Shalës Lush Prelën, për lirim të 200 malazezëve të zënë robër dhe të çarmatosur. Thekson "Ai me Mikiqin ka qenë si vëlla, pasi që në bisedë janë dakorduar që banorët e Velikës janë me prejardhje Shaljanë, dhe me shpërnguljen në Velikë, nën presionin e Vasojeviqëve nga katolicizmi kaluan në besimin ortodoks, dhe ai propozon që lufta të ndërpritet... Kostadini i ka bërë kërkesën që t'u kthejë armët për dy çetat e Polimles, të cilat i kanë çarmatosur dhe se do ta lëshojnë territorin e Shalës dhe të shkojnë drejt Gucisë gjatë ditës së sotme dhe të nesërme. Pas një mosmarrëveshjeje të shkurtër, Shaljani ka rënë dakord dhe ka thënë: "Po të mos ishim vëllezër, dhe po të ish ndonjë tjetër komandant malazez, unë me të do vepra ndrysh."

V. O: Fshati Velikë, është në komunën e Plavës, Mal i Zi.

Përgatitë për botim, Marko Jokiq

Një familje shqiptare në Caen të Francës

I lodhur nga zhurma politike, që në këto ditë të fushatës së zgjedhjeve të 23 qershorit e ka trefishuar ndotjen e mjedisit, u futa në internet në kërkim të ndonjë aventure çlodhëse. Shigjeta e "mauzit" më kapi një lajm interesant: Një shqiptare e vogël, me emrin Florida, 14 vjeçare, me 30 mars 2013 zuri vendin e dytë në një konkurs për "Top modele", organizuar në një rajon të Parisit, kryeqytetit të Francës. Disa muaj më përpara edhe motra e saj e vogël Fidela, mori pjesë në "Miss Franca 2012" për moshat e vogla dhe midis 1300 fëmijëve konkuroes u radhit në vendin e gjashtë.

Për fatin tim të mirë, dy motrat e vogla dhe prindërit e tyre ishin nga Dukagjini i Shkodrës, çka ma bëri të lehtë njohjen me historinë interesante të kësaj familje që ka emigruar në Francë qysh në vitin 1999 dhe është vendosur në Caen (Base-Normandia), një qytet në veriperendim të vendit, me rreth 400 mijë banorë. Midis të tjerave Caen përmendet edhe si qyteti i Guillaume le Conquerant, ish mbret i Francës.

28 vjeç ishte Pëllumb Çetina nga fshati Lekaj te komunes se Shales, zona e Dukagjinit në Shkodër, kur në vitin 1999, së bashku me bashkëshorten Bardhën dhe me Foridën e vogël motmote, do të merrte rrugën e mundimshme të emigrimit. Me dhimbje në shpirt për ndarjen nga trualli i të parëve dhe plot vështirësi udhëtimi, çifti i ri i sapo trashëguar, kapërcëu Adriatikut dhe mbërriti në vendin e Bonapartit të madh, për një jetë më të mirë. Fillimisht bëri jetën e refugjatit, si shumë të tjerë, por falë korektësisë dhe gadishmërisë për çdo lloj pune, Pëllumbi dhe familja e tij e vogël do të stabilizohej në Caen, me punë dhe strehim. Ai e nisi me zanatin e shoferit, zanat që nuk i ndahet edhe sot. Ndërsa Bardha, pasi siguroi diplomën e gjuhës frënge, nisi punën si përkthyes në Gjykatën e qytetit, në policinë nacionale dhe në Gjendarmëri.

Në vitet që pasuan familjes së vogël iu shtua numri dhe gëzimi. Florida, që tash vijon klasën e tetë, u bë me motër dhe me vëll. Fidela do të quhej motra që lindi dy vjet më pas e që sot është në klasën e gjashtë. Ndërsa vëllai, Floriani, ishte pak më "serioz": Vetëm mbas pesë vitesh u bashkua me dy motrat dhe sot

është duke përfunduar klasën e parë.

Përveç të dhënave që mora nga babai i Pëllumbit, Martini, i cili banon në Shkodër, u lidha edhe në telefon me këtë familje për të mësuar diçka më tepër për jetën e tyre në Francë. Në Caen ku ata

riani, që u bënë dhe "shkak" i nisjes së këtij shkrimi. Dy motra e një vëlla, sejcili me botën e bukur të fëmijës, që kanë nisur rrugën e jetës larg Atdeut të tyre, por asnjëherë të mohuar. Që të tre janë nga nxënësit më të mirë të shkollës ku

shurdhuese të politikës sonë bajate, të mbërthyer me denigrime, sharje e mallkime për njëri-tjetrin, kemi harruar se në mesin tonë kemi mjaft shqiptarë të mirë e të zot, të cilët kanë çarë në jetë me punë e jo me llafe, duke nderuar veten, por



punojnë e banojnë ka dhe shqiptarë të tjerë, kryesisht nga Kosova. Por familja Çetina është më e njohura ndër ta. Dhe kjo falë veprimtarisë atdhetare që zhvillon Pëllumbi, veçanërisht në përvjetorët e festave tona kombëtare. Në një gazetë franceze të vitit 2002 shikojmë Pëllumb Çetinën së bashku me shkrimtarin tonë Ismail Kadare dhe shqiptarë të tjerë në festimin e ditës së Flamurit dhe të Çlirim-it. Ky djalë i ri dukagjinasi, bashkë me shqiptarë të tjerë, kanë krijuar edhe "Shoqatën Iliria", e cila përcjell trashëgiminë patriotike, kulturore dhe artistike tek emigrantët shqiptarë e fëmijët e tyre.

Por edhe Bardha, bashkëshortja e Pëllumbit, nuk mbetet prapa në kontributet e saj. Ajo në radhë të parë kujdeset për fëmijët, veçanërisht për Fidelën dhe Florianin të lindur në Francë, që të mësojnë si duhet gjuhën shqipe. Dhe ia ka arritur. Kur në pushimet e verës familja Çetina vjen në Shqipëri e në Lekajin e tyre të Dukagjinit, të tre fëmijët flasin shpengueshëm me moshatarët e tyre të vendlindjes së prindërve.

Por le të kthehemi tek tre fëmijët e familjes Çetina: Florida, Fidela dhe Flo-

mësojnë. Siç thamë më lart, Florida që vijon klasën e tetë, siguroi vendin e dytë në konkursin për "Top modele", organizuar nga një shoqëri private. Por "top-modele" e vërtetë, ajo dëshiron të bëhet në jurisprudencë. Fidela, që është dy vjet më e vogël, është pak e mërzitur, sepse në 1300 konkuroeset e moshave të vogla për "Miss Francën 2012", ka zënë vetëm vendin e gjashtë. Megjithatë nuk "dorëzohet". Ajo do të konkurojë përsëri, krahas dëshirës së madhe për t'u bërë, pse jo, një stiliste e famshme. Ndërsa Florianin gjashtë vjeçar, si shtyllë e shtëpisë, ka zgjedhur një aktivitet më serioz: Është futbollist në ekipin e të vegjëlve të shkollës. Ekipi përbëhet nga 12 sportista. Së bashku me ekipin e tij finalist, ka marrë edhe medalje. Ndryshe nga motrat, ai tani për tani, dëshirën e parë dhe të vetme ka futbollin. Ndoshta nesër do ta shohim në ekipet e famshme të Francës, si Platini. Dhe doemos edhe në ekipin tonë kombëtar, sepse prindërit e tij, Pëllumbi e Bardha, mbi gjithçka i ushqejnë dashurinë për Lekajin, për Dukagjinit, për Shqipërinë.

Të zhytur në pluhurin dhe zhurmën



edhe duke rritur imazhin e Shqipërisë, që shpesh herë me sjelljet tona e plandosim në baltën e rrugës, sikur të ishte një leckë e pavlerë.

Dhe raste të tilla si ky i familjes Çetina kemi plot, si brenda vendit, ashtu dhe në mesin e emigrantëve tanë nëpër botë. Por lapsi ynë gazetaresk është mbërthyer pas së keqes, pas të shëmtuarës, pas asaj që vërtitet në pluhurin e rrugës e që na jep skupin e ditës, duke kujtuar se po bëjmë "interesanten", por në fakt bëjmë faqen tonë të zezë.

Mund dhe duhet të dalim nga ky rreth vicioz i neveritshëm. Arsyet, faktet dhe personazhet nuk na mungojnë. Le ta kërkojmë personazhin e vërtetë të ditës, e të lëmë mënjatë karikaturën groteske të politikës dhe sojsezëve të saj për vodevilët e skenave tona humoristike.

Nga Gjon Bruçaj

POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI

Rinisë që më iku !

Moj rini më ike

Sa duhet nuk të mora erë,
M'u kthe edhe njëherë!

Rini: Dhuratë natyrore e përtëritjes njerëzore
E krijimit dhe e transformimit,
E diturisë dhe e bukurisë,
Për Atdehun në ballë të trimërisë.

Ti rini që gjithë shkencat i përvetëson,
Që në të gjitha fushat vazhdimisht përparon,
Ndaj dhe natyra gjithë të mirat të afron,
Kur stafetën brez pas brezi përpara çon!

Kur të pata në dorë,
Isha madhështor, si mali me borë.
Të dhashë e më dhe shumë kënaqësi

Gjatë jetës, rininë e fala për Liri,
E fala e s'u bana kurrë pishman,
Se e dhashë për Shkodër e Vatan!

Qeshë i ri, si pranverë,
Në mes të luleve të bukura u ndodha shpesh-herë,
Polenin ma dhanë e polenin u dhashë
Për askënd në botë nuk u bana mashë.
Edhe në acarim më të madh të jetës
Unë kërkova dhe gjeta lulen e së vërtetës,
Prita të dashurën nën çati,
Edhe pse binte borë, breshër e shi,
Në krahët e njeni-tjetrit ndjenim veç kënaqësi.

Veç mbramjet e vallzimit qenë gëzimet tona
Tuej këndue e vallzue deri orëve të vona,
Me padurim prisnim sa të errej nata

Nën dritare të dashnores të banim serenata,
Dhe ishte fatlum kush me vajzën bridhte,
Pas mbramjes s'vallzimit në shpi ta përcillte.

Kur vinte behari në pikniqe shkonim,
Nëpër livadhe vajzën e takonim,
E nëse këpusnim lule, asaj ia dhuronim!

Në fusha futbollit, lumenj e liqe,
Të parët në gara kudo ishim ne!

Me hov djaloshtar kudo në Shqipëri shkuam,
Në qiejt e pafund si shqipe fluturoam,
Me djersën e ballit historinë e shkruam.

Çfarë të të them tjetër, o e arta Rini,
Për gazin e kangët në Vitin e Ri,
Që e kalonim gëzueshëm kudo në shoqni!

E tash që pleqnisë ka vite që iu qasa,
Më erdh parasysht i madhi Pashko Vasa,
"Po tash "në pleqëri", pa më thuej si je?
Porsi njaj lisi i rruem përdhe...",
Me fytyrën e rrudhun e me flokët borë,
Tuej ecë ngadalë, mos t'thyejmë kambë e dorë,
Ne, t'rinjtë, që dikur në dashni bamë emër,
Tash shohim me sy e "plasim" me zemër,
Ne, që dikur fluturonim maje më maje,
Tash i biem maces me lugë e bëjma llogje kavaje...

Kthehu, moj Rini, kthehu dhe një herë,
Kthehu në pleqëri e më ban pranverë!

Nga Haki Temali

Ndue Ftoni, Konsull Nderi i Humanizmit

Nëpërmjet "Albreams" në diasporën shqiptare të Amerikës dhe veçanërisht në atë të Miçiganit mbërriti një lajm i mire. Ketë na e solli Rush Dragu. Vendlindja e Ndue Ftonit e ka nderuar në mënyrën me të larte, duke e shpallur atë "Qytetar Nderi" të komunës së Shoshit, në zonën e Dukagjinit. Ketë titull ia dorëzoi Kryetari i komnes, Mark Kulla.

Kur të vlerëson vendlindja tregon se emigrimi biblik është kthyer në një urate dhe kujtese për token tende. Edhe një zgjim i atdheut për të kujtuar bijtë e tij. Dhe me të drejte Ndue Ftoni, pasi në diasporën e Miçiganit u shprehen "Personalitet i 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë" i vjen në krah një titull tjetër ai i qytetarit te nderit.

Ndue Ftoni e nisi punën në Amerike siç e nis çdokush. Nuk ka punë të lehte në Amerike, por ka mundësi të jashtëzakonshme. Pasi punoi fort ai ngriti një këmbë të urës. U tregua i guximshëm dhe nguli një gur në biznes, më pas vuri një tjetër dhe kështu edhe një tjetër sa u krijua katërkëndëshi i baza-

personalitete amerikane, si kongresmen e senatore me tituj mirënjohje. Veçanërisht ai organizoi mbrëmjen e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë dhe shtroi një darke falas për 1 400 shqiptare nga të gjitha krahinat dhe besimet fetare.

Ndue Ftoni në veçanti nga të tjerët nuk



mentit. Po ura e urtësisë dhe e humanizmit nuk qëndron në një këmbë. Kështu ai vuri themelet e këmbës tjetër me humanizmin e shpirtit të tij. Mbi këtu dy themelet e shtroi me bujarë dhe dhurata lidhjen e brigjeve diasporë-vendlindje. Me të drejte Ndue Ftoni është konsulli i humanizmit në diasporën shqiptare të Amerikës.

Në diasporë pra, vetëm në Miçigan dhe New-York veprojnë 250 organizata dhe shoqata atdhetare. Në mes tyre edhe ajo "Dukagjini" me njërin nga njerëzit më të nderuar, si kryetar i saj Nikolin Shyti. Po ne vendlindje asnjë nga shoqatat e Detroitit nuk ka si motrën e vet, vetëm shoqata "Atdhetare-Dukagjini" Ajo ekziston dhe vepron në Shkodër me kryetar Ndue Sanaj, i cili së bashku me Mjeshtrin e Madh, Fadil Kraja i dorëzoi Ndue Ftonit titullin e larte "Nderi" i shoqates. Dhe ky është një rast i vetëm që kërkon të vlerësohet dhe brenda këtij organizmi atdhetar lëvizin për bukuri zambaku edhe venat e gjakut të genit shqiptar të Ndue Ftonit. Ai është nderuar edhe nga

krijoi një shoqatë që të dale në krye të saj dhe të mos shqitet ma sa çimçakizi në dhembe. Por ndihmoi në mbarëvajtjen e shoqatës atdhetare "Dukagjini" që është një thesar promovimesh të vlerave tona të traditës.

Ka qene një bir tjetër dukagjinas, Dom Prek Ndevashaj themeluesi i pare i kishës katolike "Zonja Pajtores" në shtetin e Miçiganit, i cili organizoi për 30 vite festën e flamurit tone nacional në "The Imperial House", që tani është nen pronësi të dukagjinasit Ndue Ftoni. Ai është një shqiptar midis dy arterieve dhe si çdo patriot e ka të shenjte fjalën. Me gjithë energjitë e tij ai është në krah të veprimtarive të diasporës për të ngritur platformën e vitalitetit të njerëzve që kontribuojnë aq shumë.

Brenda nderimeve që po i shtohen Ndue Ftonit, siç i shtohen qiellit engjëjt e bardhe të lajmit të mire kemi edhe ne pse të krenohemi.

Diaspora dhe kultura shqiptare ka nevojë për njerëz si Ndue Ftoni.

Nga Zef Pergega

VDES NË ITALI, GJOVALIN KOLA NGA FSHATI PLANI I KOMUNËS PULT

Gjovalin Kola, 39 vjeç, me origjinë shqiptare dhe në banim në Monkiero, ka vdekur, sipas të gjitha gjasave nga një shok anafilaktik, i provokuar nga pikimi i një insekti.

Ka qene ora 17.30 Gjovalini, farkëtar artizan, ishte duke lyer murin e një shtëpie në një familje nga Maljano Alpi. Ishte duke punuar kur i është drejtuar të zonjës së shtëpisë, duke i thënë se e kishte pickuar një insekt. Gruaja ka kërkuar menjëherë një dezinfektues, por kur është kthyer në dhomë, e ka gjetur atë të rrezuar përtokë, pa ndjenja.

Ka thirrur menjëherë 118-en, mjekun e zonës dhe karabinierët. Në pak minuta ka arritur ambulanca, por efekti i helmit të insektit ka qene shumë i shpejtë. Ai ka vdekur para se mjeket të ndërhyjnë. E menjëhershme ka qene edhe gatishmëria e karabinierëve të stacionit të Doljanit dhe tekniket e "Shpresa". Fakti i është bërë i ditur edhe Prokurorisë së Republikës të Moregalos, nga e cila është pritur leja e varrimit, por nuk është përjashtuar mundësia e bërjes së autopsisë së trupit të artizanit, për të sqaruar faktet. Trupi është vendosur në dhomën mortore të varrezave të Mondovise.

Gjovalin Kola ishte me origjinë nga Shkodra, në Shqipëri. Pati lenë tokën e tij në vitin 1995 për të arritur në Itali dhe menjëherë është vendosur në Granda, ku ishte shumë i njohur dhe i respektuar. U vendos me kushirët e tij në Lekuio Tanaro. Pasi gjeti punë në kantinën e Mauro Maskarelos, u transferua përgjithmonë në Monkiero.

"Ka punuar me ne për 12 vjet", tregon nga kantina, Mauro Maskarelo. "Ishte një person i veçantë dhe një punëtor i madh".

Në 2008-en, ka filluar një aktivitet me vete. Ishte farkëtar artizan, por dinte të bënte shumë punë të dobishme në shtëpi. "Në atë zonë të gjithë e thërrisnin Xhivanin – thotë kryetari i bashkisë së Monkieros, Xhovani Botino. "E donim të gjithë shumë", thotë ai.

Në Itali kishte disa të afërm, mes të cilëve Zef Bungu, i cili është marrë me njoftimin e familjarëve në Shqipëri. Në vendlindjen e tij kanë mbetur nëna Drande 80 vjeçe dhe vëllai Gega. Familja ka qenë me e madhe, por në vitet e kaluara kane vdekur vëllai Kola 26 vjeç dhe motra Sofie 31 vjeçe, e cila ka lënë burrin dhe tre fëmijë.

"Është një humbje e madhe", thotë



kushëriri, Zefi. "Për varrimin, i cili do të bëhet në Shqipëri, kemi njoftuar të gjithë të afërmit tanë që ndodhen në Itali. Për momentin kemi fiksuar vetëm lutjet që do bëhen të premtën në mbrëmje në famullinë e Monkieros.

Marrë nga gazeta "La Stampa"
Përktheu Luigj Mila

Gjovalin Nosh Kola, bir i familjes me emër të Kolë Mark Prelë Ujkës, ndroi jetë në Itali duke lënë në pikllim të thellë nusen e tij, Klodila (Klodi), nënën Drande, Vëllain me nusin e tij Florën dhe fëmijët, vjehrrin dhe familjen e tij, të afërmit, kushrinjtë, dhe gjithë të njohurit e tij dhe të familjes së tij.

Pjesmarrja e jashtëzakonshme e banorëve të Planit, Pultit dhe gjithë Dukagjinit, por edhe shumë e shumë të tjerë shumë më gjerë, ishte tregues i vlerësimit të Gjovalinit dhe të gjithë familjes së tij.

Ai u varros me datën 29.05.2013 me të gjitha nderet dhe respektin tradicional dhe bashkëkohor.

Lamtumirë djali, vëllaj, kushriri, nipi, daja, dhëndri, miku dhe shoku i mirë i të gjithëve.

Pushofsh në paqe.

Luigj Mila
Luigj Shyti
30 maj 2013

REDAKSIA
Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri,
Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja,
Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja